



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 14 TETOR 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
14. OKTOBRA 2010. GODINE

TETOR – OKTOBAR
2010

E enjte, 14 tetor 2010, ora 10:00

Drejtën seancën: Anëtarë i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Mirëmëngjesi!

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Qeverisë së Kosovës,

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, fillojmë me deklarimet e deputetëve, përkatësisht të grupeve parlamentare për çështjet që nuk janë në rend të ditës. Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, të tjerat i dimë.

Në seancën e kaluar kanë mbetur pa diskutuar 4 deputetë: Myrvete Pantina, Nait Hasani, Xhevdet Neziraj, Gani Geci.

E ftoj deputeten Myrvete Pantina ta marrë fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Çështjen që e ngrejë sot paraqet një shqetësim të madh për punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara, të cilët deri më sot nuk kanë mundur të gëzojnë të drejtën e tyre që ju takon. Është fjala për punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara të cilët gëzojnë të drejtën e përfitimit të 20% nga ndërmarrja e privatizuar, të cilët janë të brengosur për zvarritjen e mospagesës të obligimit që ju takon. Edhe pse Komisioni i Agjencionit Kosovar të Privatizimit i ka shqyrtuar të gjithë emrat e punëtorëve dhe i ka përgatitur listat përfundimtare të punëtorëve të 27 ndërmarrjeve që duhet të përfitojnë nga 20%, Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk po i miraton ato lista. Mendoj se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme duhet të sqarojë çdo paqartësi po që se ato ekzistojnë dhe të lejojë kryerjen e obligimeve të AKP-së ndaj këtyre punëtorëve. Përndryshe, Oda e Veçantë duhet të tregojë arsyet e mos miratimit të këtyre listave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar!

Përshëndetje kolegë!

Për mua sot është një çështje që vazhdimisht është kah e preokupon, vazhdimisht ka qenë në rend të dite disa herë, po është hequr, ku di unë për çka. Ministria e Punëve të Brendshme është çështje e vjedhjeve, po nuk është vetëm e vjedhjeve në sirtarët e Policisë, por është vjedhje edhe nëpër sirtarë e Prokurorisë edhe në Prizren, edhe në Pejë, edhe në shumë vende të tjera. Kërkoj nga ministri i Punëve të Brendshme të na tregojë që me datën 23.6.2006, në Prizren janë vjedhur diku 5 kilogram e 721 gramë heroinë në Prokurorinë, te kryeprokurori i Qarkut të Prizrenit dhe asnjë veprim, asnjë masë nuk është marrë ndaj kësaj. Po ashtu, është edhe në Pejë, po ashtu edhe në Prishtinë. Me këtë tregohet që krimi i organizuar është pjesë e brendshme apo është luftë kundër kësaj? Mendoj që këto çka duhet të bëhen, janë kërkesa edhe të Qeverisë, por a janë me veprime apo janë veç me fjalë? Nëse janë me veprime, mendoj që ka ardhur koha të japim deklarata, të japim vendime edhe të shihen rezultatet e gjithë kësaj.

Tjetra, si çështje është që tani ne fillojmë me zgjedhjet, jemi në përgatitje për zgjedhje të reja parlamentare. Një çështje që unë kërkoj ta ngrehim këtu, është edhe çështja e rezolutës për dënimin e krimeve të totalitarizmit, të cilat kanë ndodhur në Kosovë dhe këtë mendoj që nëse duam ta kemi një Kuvend të pastër, nëse duam ta kemi një Kuvend që vërtet i mbron interesat e qytetarëve të Kosovës, nëse duam ta kemi një Kuvend që është në shërbim të popullit të Kosovës, atëherë duhet që ta miratojmë rezolutën, t'i bashkohemi botës demokratike dhe ta nxjerrim Ligjin për lustracionin, që

Kuvendi i ardhshëm i Kosovës të jetë i pastër, i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Në të kundërtën, unë nuk di a janë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës apo Ligji i lustracionit do të na kishte nxjerrë me defekte të mëdha këtu te ne.

Një tjetër është që ne duam të ecim përpara...

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, kolegë deputetë,

Unë do ta ngrejë një çështje që e kam pas ngritur edhe më herët dhe më vjen mirë që këtu është ministri i Pushtetit Lokal, është në lidhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, ku në Fushë Kosovë subjekti ynë politik IRDK-ja, komuniteti egjiptas ka fituar më së shumti vota dhe i takon që të jetë zëvendëskryesuesi nga radhët e këtij komunitetit. Edhe pse këtu kam ngritur një çështje - pyetje parlamentare dhe Komisioni për Komunitete ishte në Fushë Kosovë dhe që një vit nuk e ka kryer këtë obligim ligjor, do të thotë që komuna e Fushë Kosovës, Kuvendi i Fushë Kosovës ka shkelur ligjin, ka shkelur Kushtetutën dhe në një farë forme nuk është duke ua dhënë të drejtën, atë që u takon me ligj.

Një problem tjetër që duhet të merret ky Kuvend, është edhe implementimi i Ligjit për promovimin e komuniteteve, ku në Ligjin për promovimin e komuniteteve është shumë qartë e shkruar se në ndërmarrjet publike duhet të ketë njerëz të punësuar edhe nga radhët e komuniteteve minoritare. Me këtë rast dua veç ta cek një rast, ku Komisioni për Komunitete ka bërë verifikimin dhe implementimin e Ligjit për promovimin e komuniteteve në këto ndërmarrje publike, nga 7600 punëtorë, në KEK nuk është asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptas i punësuar, në PTK, nga 3000 e kusur të punësuar, nuk është asnjë pjesëtarë, edhe pse kanë konkurruar njerëz me përgatitje superiore. Do të thotë, që Ligji për promovimin e komuniteteve nuk është duke u zbatuar. Prandaj, është detyrë e këtij Kuvendi që të përcillen se ligjet nuk janë duke u implementuar në praktikë. E vetmja Ministria për Komunitete dhe Kthim është duke bërë një punë të mirë për arsye se për 3 vite, nga 24 milionë të buxhetit, mbi 20 milionë i ka harxhua për komunitetin serb, kryesisht të Partisë Liberale, nga edhe udhëhiqet kjo ministri, ndërsa në komunitetet tjera nuk e kanë shfrytëzuar shumë, shumë pak ose asnjë centë.

Një problem tjetër është që Kuvendi duhet të shikojë këtë implementimin e ligjit, gjithashtu edhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, detyra e të cilit është që të shikojë a po realizohet Ligji mbi promovimin e komuniteteve, e jo vetëm të merret rreth decentralizimit. Do të thotë, e kisha lutur këtë Kuvend, por edhe Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar të shikojë se a po implimentohen ligjet apo vetëm po votojmë ligje dhe ato në praktikë asnjë s'është duke u zbatuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Unë dua t'i ngrejë dy çështje të rëndësishme që kanë ndodhur këto ditët e fundit.

E para, është vërja dhe heqja e flamurit kombëtar shqiptar nga shtyllat për nder të ardhjes së zonjës Clinton. Mua ma përkujton heqjen dhe djegien e flamurit dardan. Atëherë nuk ishit ju në pushtet, por dhatë urdhër që dikush nga rruga t'i djeg ata flamuj. Dhe tash, meqë jeni në pushtet, prapë erdhi urdhri nga lart, por jo për t'i djegur, me ato kamionetat e vogla ta largoni flamurin kombëtar shqiptar.

Atëherë thirreshit në flamurin kombëtar shqiptar, ndërsa tash thirreni në flamurin e Republikës së Kosovës. Megjithatë, problemi ka qenë - kush dha urdhër atëherë për t'i qitur, dhe kush dha urdhër tash për t'i hekur dhe atëherë për t'i djegur. E para kjo ishte.

E dyta, të nderuar deputetë, kur u shpall pavarësia e Republikës, këtu në hollin e Kuvendit të Kosovës ishte fotografia e presidentit. E dhatë prapë një urdhër, pra ishte urdhër natën, e hoqët fotografinë e presidentit Rugova, natën e hoqët, me urdhër të natës, por me urdhër të ditës nga miqtë tanë më të fuqishëm ndërkombëtarë, e kthyet ditën, e kthyet se nuk ua majti për ta mbajtur fjalën. Megjithatë, e kthyet atë, por tash me kohërat para fushatës, në zyrën e ish presidentit Rugova, presidentit legjendar e hoqët fotografinë e presidentit Rugova, e hoqët sepse e keni për dëshirë ta vëni fotografinë e Stalinit e të Leninit ose edhe të xhaxhit Enver, por fatmirësisht nuk e vutë, e vutë deklaratën që ishte për nder. Por, e hoqët fotografinë e presidentit Rugova, sepse po mundoheni ta përdhosni veprën më të madhe historike të kombit shqiptar. Këtë nuk po mund ta bëni, sepse po vinë mu në këtë foltore burrat e mëdhenj, si Bill Clinton dhe Toni Bler dhe po ju shpjegojnë se vepra e tij është shumë e fuqishme, ai ka qenë shumë i fuqishëm, edhe më i fuqishëm ndoshta se ne të gjithë së bashku, sepse për nder të tij, ati ia kishin pas dhënë fjalën se do t'i ndihmojmë Republikës së Kosovës dhe nuk do të lëmë pastrimin etnik të Kosovës nga hordhitë serbe. Megjithatë, këto po i bëni për t'i militarizuar militantët e juaj, po fajtor kryesor për këtë është udhëheqja e ngrirë, e shkrire, udhëheqja që e shkeli Kushtetutën, s'e shkeli Kushtetutën. Për të gjitha këto marifetllëqe, fajtor është ngrirja e shkrija, frigoriferi, nxjerrja nga frigoriferi atëherë kur i nevojitet Lidhjes Demokratike të Kosovës. Prandaj, zoti ju ndihmoftë ju të dyve, dy palëve që jeni në pushtet, se kjo që po...

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Unë sot e mora fjalën, disa herë e kam ngritur çështjen e studentëve, pranimin e studentëve në konviktet e Kosovës, në konviktet e Universitetit të Prishtinës, në Prishtinë. Siç po shihet, kemi edhe fakte, mund t'ua them edhe emrat, që ka shumë studentë të cilët vinë nga Krusha e Vogël dhe Krusha e Madhe, të cilët i kanë humbur familjarët e tyre, baballarët e tyre dhe nuk pranohen në këto konvikte të studentëve. Andaj, kërkoj nga ministri i Arsimit që ta ketë nën kontroll dhe të shohë, jo vetëm të bëjë fushatë, por të shohë se si po funksionon Qendra e studentëve në Prishtinë, po ashtu si po funksionon Rektorati, të vendos tashmë për semestrin e studentëve, jo të mbetet vetëm me deklarata publike, por të merret vendim dhe studentët mos të paguajnë nga 50 euro dhe, po ashtu, të mos i lënë në gjendje të mjerueshme studentët të cilët vinë nga Krusha, sidomos, edhe nga rajonet tjera të cilat kanë pësuar gjatë luftës së fundit në Kosovë, që këta studentë të jenë të privilegjuar sikurse studentët tjerë, të cilëve ju garantohej me ligj. Andaj, unë kërkoj nga ministri i Arsimit që të marrë masa të menjëhershme që këta student të mos mbesin jashtë dyerve të konvikteve apo jashtë vendeve strehimore për studentët tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Duke marrë parasysh proceset e rëndësishme nëpër të cilët do të kalojë Kosova, shpreh shqetësimin tim në lidhje me proceset politike në Shqipëri në mes të pozitës dhe opozitës, sepse sipas informacioneve që ne kemi, përleshjet e tyre dhe politikëbërja e tyre në rrugë, të themi, dhe mbi baza krejt personale, është duke dëmtuar rëndë çështjen e Kosovës, sidomos në Bruksel. Prandaj, është koha e fundit që politika atje të merret vesh në një rrugë institucionale. Në të njëjtën kohë, kisha për t'i bërë thirrje Kuvendit që të marrë një qëndrim ose edhe Komisioni për Punë të Jashtme mund të bëjë një vizitë atje dhe, me fjalë të tjera, të involvohet në një apel që këto çështje të hynë në linjën institucionale dhe shqiptarët përfundimisht të mësohen të bëjnë politikën në institucione, e jo mbi baza personale të njerëzve të fuqishëm, të cilët dëshirojnë gjithçka ta shndërrojnë për punën e vetë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

(Ndërrhyrje)

Nuk je, ke të drejtë të ankoresh.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me deklaratën e sotme unë dëshiroj të shpreh shqetësimin për fillimin e fushatës parazgjedhore të kryeministrit dhe të Qeverisë, i cili, gjatë vizitave që po iu bën kohëve të fundit komunave të Kosovës, po bën premtime të shumta elektorale. Po filloj me premtimet që ka bërë në Pejë, pasi ka filluar nga Peja. I bëri premtime biznesit, stafit akademik dhe studentëve, veteranëve e zyrtarëve të komunës. Harroj se ka bërë edhe më parë premtime vitin e kaluar. Ku ishte, zoti kryeministër, para dy viteve, a duhet besuar premtimeve tuaja? Më 2010, Peja u diskriminua në krahasim me komunat tjera në ndarje të këtij buxheti. Po i paraqes faktet, duke i krahasuar të dy komunat që kanë numër të njëjtë të banorëve dhe hapësirë të njëjtë. Derisa komunës së Prizrenit iu ndanë 25 milionë ose afër 26 milionë, në anën tjetër për shpenzimet kapitale iu ndanë 12 milionë e gjysmë dhe nga ato 8 milionë grande qeveritare. Komunës së Pejës iu ndanë afër 14 milionë e gjysmë, pra 11.600.000 euro më pak se komunës së Prizrenit, për shpenzimet kapitale iu ndanë afër 5 milionë apo 7.5 milionë euro më pak se Prizrenit, kurse nga grandet qeveritare afër 3 milionë apo 5 milionë euro më pak se Prizrenit. Në zgjedhjet komunale, kryeministri Thaçi premtoi investime kapitale për Pejën prej 155 milionë eurove, natyrisht, nëse zgjidhet kandidati i tyre.

Kështu, kjo Qeveri po i dënon qytetarët e Pejës pse nuk e kanë votuar PDK-në. Një gjë është e vërtetë, asnjë premtim të dhënë kryeministri, gjegjësisht kryetari i PDK-së nuk e mbajti.

Të nderuar deputetë,
Është shkelje e ligjit bërja e fushatës nga pozita e kryeministrit...

KRYESUESI: Ju lus për qetësi, ju lus për qetësi!

GJYLNAZE SYLA: ...dhe përdorimi i institucioneve të shtetit dhe të mjeteve të tyre për lobim vetanak dhe lobim partiak. Në fund të fundit, me para të kujt po shëtitet e bën fushatë kryeministri i Kosovës? Sigurisht që me paratë e taksa paguesve. Ministrat përderisa të kenë këto pozita të shtetit dhe përderisa kryeministri është kryeministër, duhet të punojë për shtetin, të përmirësojë jetën e qytetarëve, 24 orë rrymë - siç premtoi, më shumë punë - siç premtoi, luftën kundër korrupsionit - siç premtoi, natyrisht, të gjitha këto nuk i realizoi. Se si do të mbahet në mend kjo qeveri, mbase më së

miri e paraqet vetë slogani i PDK-së gjatë zgjedhjeve lokale 2009, “premtoi, nuk e bëri, dështoi”. Është e qartë çfarë i intereson kryeministrit, është pushteti e jo shteti.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Vëtret, meqë ndodhemi edhe para zgjedhjeve të lira, edhe bina e foltorja e Kuvendit po shfrytëzohet për fushatë elektorale dhe sukseset e Qeverisë dhe të kryeministrit, posaçërisht, të përpiqen t’i kthejnë në konotacion negativ. Është shumë mirë që kryeministri gjen kohë për t’i vizituar komunat dhe për t’i realizuar planet dhe projektet të cilat i ka premtuar më herët dhe është duke i realizuar tash.

Unë e mora fjalën për të përshëndetur votimin e Parlamentit Evropian në favor të liberalizimit të vizave për Shqipërinë dhe Bosnjën dhe tani ka ngelur vetëm Kosova. Desha t’i rekomandoj Ministrisë së Integrimeve Evropiane dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme që ta sforcojnë angazhimin e tyre në drejtim të forcimit të strategjisë të integritetit edhe të Kosovës, në mënyrë që të futemi në agjendën e Selanikut dhe në agjendën evropiane, e cila parash integritetin e Ballkanit perëndimor, njëkohësisht. Pra, politika e jashtme e Kosovës do të duhet të përqendrohet në atë që të mos ketë shtete të cilat thuaj se janë në nivel të njëjtë të zhvillimit me Kosovën, prioritet në drejtim të integritetit. Është shumë e vërtetë që ne jemi më mbrapa se sa të tjerët, për arsye se më vonë jemi bërë shtet, por që mundemi t’i shtojmë angazhimet edhe më shumë dhe mundemi që në një farë mënyre edhe të involvohen edhe mekanizma të tjerë, përfshirë edhe Komisionin parlamentar për Politikë të Jashtme, që të jenë më aktiv në drejtim të zhbllokimit të situatës dhe të përfshirjes së Kosovës në një të ardhme të shkurtër në integritetin dhe në procesin e liberalizimit të vizave. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit, ushtrues detyre i kryetarit të Republikës së Kosovës, mirë bërë që erdhe, ma dhe fjalën. Fjalën e kam kërkuar nga seanca e kaluar, ndërsa vendasi im, Xhavit Haliti, s’di, u frikua, s’di pse s’deshi të ma japë fjalën. Edhe me këtë e dëshmoni se vërtet jeni më i zoti, mund t’i përballoni dy poste të cilat i keni.

Të nderuar kolegë deputetë, dhe zoti kryetar i Kuvendit dhe ushtrues detyre të kryetarit të Republikës së Kosovës,

Do t’i ngrejë dy çështje sot në këtë Kuvend. Si pasojë e shkeljes së ligjshmërisë dhe të Kushtetutës nga ju dy partitë në pushtet, kemi një gjendje shumë të rëndë në vend deri te kriza politike, por edhe institucionale. Si pasojë e shkeljeve kushtetuese, ne duhet të mbajmë zgjedhje të parakohshme, të cilat pretendohet që të mbahen shkel e shko, të manipulohen prapë duke bërë shkelje në themelin e demokracisë për një vend, sepse pa zgjedhje të drejta, fer, në përputhje me ligjet nuk ka zgjedhje të lira dhe demokratike. Prandaj, unë ju shtroj pyetjen para se t’i drejtohem Gjykatës Kushtetuese.

Zoti kryetar, a është përmbyllur rasti i presidentit të vendit? Pse se ka kryer Kuvendi obligimin kushtetues që të shkarkojë presidentin dhe t’i kryej të gjitha procedurat kushtetuese. A ka bërë shkelje të kushtetutës në këtë rast kryetari i Kuvendit dhe Kuvendi?

Dhe pyetjen e dytë, prapë si pasojë e shkeljeve, zgjedhjet në afatin kushtetues duhet të mbahen më së largu për 6 muaj. KQZ nuk ka të drejtë të certifikojë partitë politike për zgjedhje në qoftë se ato nuk i kanë mbajtur zgjedhjet partiake në afatet kohore të përcaktuara me ligj. Në bazë të kësaj, ne dimë se prapë ju dy partitë që jeni në pushtet, nuk i keni kryer obligimet ligjore edhe në këtë aspekt. Andaj, zoti kryetar, unë kërkoj edhe nga Kuvendi dhe nga ju që sot të më përgjigjeni në këtë shqetësimin tim dhe të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hafize Hajdini.

HAFIZE HAJDINI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta ngrejë një çështje tepër të rëndësishme për shkak të ndryshimit të kohës që sot ky shi bije mbi fëmijët e komunitetit ashkali. Dua t'i drejtohem kryeministrit të Republikës së Kosovës. Pasi të gjitha procedurat në komunën e Ferizajt janë duke u kryer, e falënderojmë Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Ferizajt dhe të Prishtinës. Pasi Zyra e kryeministrit në memorandum shkruar se kontribuon me 200 mijë euro, kërkoj nga zoti kryeministër ta përshpejtojë procedurën se sot është një kohë me si dhe bien mbi fëmijët e komuniteti ashkali. Dua t'i tregoj këtij Kuvendi se kam kritika të shumta në media lokale në Ferizaj dhe kërcënime telefonike se komuniteti thotë - na ka gënjyer Hafizja çdo ditë dhe çdo net, pasi që kanë ardhur çdo herë e kanë vizituar fshatin Dubravë dhe nuk është marrë asgjë para sysh. Vizituan me datën 4.3.2009 Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe nga Zyra e kryeministrit. Kisha kërkuar nga ju që t'i përshpejtoni procedurat e ndërtimit të banesave të 44 familjeve që janë raste sociale, pasi janë bërë vizita të shumta dhe e kanë parë gjendjen e këtij komuniteti. Kanë nevojë edhe komunat tjera për t'i ndihmuar rastet sociale.

Dhe, çështja e dytë, janë bërë kërkesa të shumta në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për material ndërtimorë, ku shumica e komunitetit ashkali jetojnë nëpër shtëpi të huaja dhe kanë nevojë për material ndërtimorë si, për shembull, është familja e Kujtim Ahmetit, Florim Kryeziut dhe Mujë Baftiut, këto famlje jetojnë në një gjendje shumë të vështirë. Kërkoj nga ju dhe nga kjo qeveri t'i ndihmoni këtij komuniteti jo vetëm me fjalë, por edhe me vepër.

Zoti kryeministër, kisha kërkuar nga ju dhe nga kjo Qeveri t'i ndihmoni këtij komuniteti. Çdo herë premtime keni pasur me fjalë, por në vepër asgjë s'keni vepruar për këtë komunitet. Faleminderit!

KRYETARI: Koha ka kaluar për deklarime jashtë rendit të ditës. Ju e dini, koha është 30 minuta. Lus regjinë që t'i evidentojë deputetët, jo tash mos u paraqitni më: Driton, Qamile, Shkumbin, Ahmet, Ismajl, Drita Maliqi, Naim Rustemi, Mark Krasniqi dhe Danush Ademi, dy të tjerë janë paraqit tash, megjithatë te Danush Ademi përfundon.

Të nderuar deputetë,

E ndjejë të nevojshme të jap një sqarim lidhur me disa deklarime që u bënë këtu, edhe pse deklaramet nuk më obligojnë.

(Reagim)

Unë, për hir të..., unë dua të deklaroj vetë, siç e keni shfrytëzuar të drejtën e deklaramet tuaj, dua ta shfrytëzoj edhe unë të drejtën e deklaramet.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që detyrën e ushtruesit të detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës nuk e kam bërë mbi zgjedhjen time personale, as mbi bazën e vullnetit tim, por e kam marrë si një obligim që e jep Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ndoshta kushtetuta i ka disa zbrazësi, për të cilat unë nuk dua të flas, por unë gjithnjë e kam parë veten si kryetar i Kuvendit, që jam zgjedhur me votat e Kuvendit. Edhe një herë po cek, detyrën e presidentit e kam marrë mbi bazën e asaj që më obligon Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ndoshta kalimi i detyrës nga ish presidenti Sejdiu te kryetari i parlamentit nuk është bërë krejt në mënyrën më të mirë të mundshme, por ekziston edhe ajo që kalimi i detyrave dhe i obligimeve të presidentit te kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të bëhet edhe në mënyrë vullnetare, por në raste të tjera.

Për çështje tjera, s'dua të hyjë, se nuk jam ekspert i Kushtetutës. Një gjë dua ta them, nuk është mirë të dezinformohet opinioni, edhe pse është dezinformuar me anë të një televizioni privat, të nivelit nacional, por dua t'ju them se jam përpjekur të krijoj një kulturë institucionale mbi bazën e ligjeve që janë në fuqi.

Ushtruesi i detyrës ose presidenti në detyrë nuk ka eliminuar asnjë fotografi të asnjë presidentit të Republikës së Kosovës. edhe pse jam i bindur në asnjë zyrë pritëse të presidentit të Kosovës, qoftë edhe në detyrë, nuk di, nuk kam parë në ndonjë vend tjetër fotografi të presidentëve të tjerë, por në zyrën time që i pres mysafirët dhe i kryej obligimet zyrtare, janë të vendosura dy fotografi, fotografia e presidentit Rugova dhe fotografia e presidentit Sejdiu. Prandaj, nuk e shoh dhe çdo deputetë prej fillimit dhe në kontinuitet ka mundësi të vjen dhe të shohë se si ka qenë dhe si është e sistemuar kjo zyrë e pritjes së ushtruesit të detyrës së presidentit. Prandaj, unë nuk kisha luajtur me fotografi, nuk kisha luajtur as me figura e personalitete që tanimë nuk janë në mesin tonë. Secili nga ne duhet t'i ofrojë vlerat e veta, kulturën e vet, angazhimin e vet për sot dhe për nesër. Unë as si kryetar i Parlamentit nuk i kam hequr nga faqja e internetit kryetarët e mëhershëm të parlamenteve. Secili ish president unë mendoj që duhet ta ketë vendin e vet në ndërtesën ose në hapësirën e presidentit dhe kjo ka ndodhur. Unë dëshiroj edhe në Parlament, por edhe si ushtrues i detyrës së presidentit ose president në detyrë të krijohet kjo kulturë që të jetë vendi i veçantë për presidentët, të jetë vend i veçantë për dhuratat dhe eksponate të ndryshme që i kanë marrë presidentët gjatë ushtrimit të detyrës dhe vërtet duhet të mësohemi ta respektojmë edhe Ligjin për presidentin që e kemi miratuar në këtë Kuvend.

Ju kisha lutur që me njerëzit që kanë dhënë kontributin e tyre në forma të ndryshme në të kaluarën, mos të bëhet lojë, se ata nuk mund të vijnë të na ndihmojnë më. Jemi ne vetë që dimë ta nderojmë të kaluarën dhe ta ndërtojmë tashmen dhe të ardhmen. Jam historian dhe jam i bindur se historia nuk fillon as nuk mbaron me ne, ajo ka filluar shumë më herët para nesh dhe sigurisht që do ta ketë rrugën e vet jetësore. Prandaj, secili nga ne që dëshiron të njoftohet me të vërtetën, i ka pasur mundësitë për t'u njoftuar. Prandaj, ju lutem, jemi deputetë, kemi votën e qytetarëve, ta ruajmë një traditë, ta ndërtojmë një traditë, ta forcojmë një kulturë dhe ta dimë se obligimi ynë është për të ndërtuar jetë institucionale në Kosovë, ta respektojmë Kushtetutën dhe t'i respektojmë ligjet në fuqi. Për këtë jemi në këtë sallë dhe jo për t'u bërë zëdhënës të ndonjë televizioni privat, që ndoshta synim kryesor ka hyrjen në politikë, por politikën e kanë provuar dhe janë dalë nga ajo, se s'kanë pasur çka t'i japin asaj. Prandaj, të shërbehen me atë që është dhe jo me ato që s'janë. Ju faleminderit, shumë!

XHAVIT HALITI: A ka mundësi veç një sqarim?

KRYETARI: Po, po, urdhëro!

XHAVIT HALITI: Unë e kam një sqarim për deputeten e nderuar Gaxherri. Nuk kam asnjë qëllim ndaj teje, listën që e kam, urdhëroni mund ta shihni, janë 4 emra të evidentuar, nuk jeni ju dhe unë zbatova strikt rregulloren duke ia dhënë fjalën më shumë opozitës se pozitës. Kjo është situata, unë nuk kam tjetër rrugë. Realisht, fjala t'u ka dhënë edhe tani pa rend, se ke qenë diku kah fundi e paraqitur.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje.

Pyetja e parë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputeti s'është këtu. Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri s'është këtu, as deputetja s'është. Vazhdojmë.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputet, e ke fjalën!

ISMAJL KURTESHI: I nderuar zëvendëskryeministër,

Ju keni deklaruar se nuk do të ketë bisedime pa u caktuar agjenda, temat dhe afatet kohore. Mandej keni thënë se ne do t'ju propozojmë tema të bisedimeve, keni thënë se në kohën e duhur dhe vendin e duhur do të merren vendimet për bisedime, po ashtu keni deklaruar se me Serbinë do të ketë negociata ndërshtetërore.

Zoti zëvendëskryeministër,

Sipas jush, cili është vendi dhe koha e duhur për marrjen e vendimit për bisedime, cili është këtu roli i Kuvendit të Kosovës, në kë konkretisht keni menduar kur keni thënë - ne do t'ju propozojmë temat. Nga aspekti legal, a ka mundësi të zhvillohen bisedime ndërshtetërore me një shtet që nuk e njeh pavarësinë e tjetrit, në këtë rast pavarësinë e Kosovës dhe a munden këto dy palë të jenë të barabarta derisa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës? Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri përgjigjet.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar Krasniqi!

Faleminderit, i nderuari deputet Kurteshi!

Faleminderit, edhe prej zëvendëskryeministrit, që ma dha këtë favor, pasi që jam edhe si kryeministër, të përgjigjem edhe në këtë çështje pasi që isha edhe më afër, por edhe nga përgjegjësia institucionale.

E para, dëshiroj të theksoj edhe një herë, siç e kemi prezantuar edhe më herët se Kosova ka hyrë në një fazë të konsolidimit dhe forcimit të shtetit, në një proces të fuqishëm të njohjeve ndërkombëtare, tani është edhe pjesë e Bankës Botërore, të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në një proces integruar. Shpejt i presim edhe Raportin e progresit dhe Strategjinë për liberalizimin e vizave. Por, natyrisht, në kuadër të përpjekjeve dhe të angazhimeve tona të përbashkëta për t'u integruar në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara sa më shpejt që është e mundur, kërkohet edhe bashkëpunim ndërshtetëror me të gjithë fqinjët dhe relacion për të mirën e vendeve dhe popujve tanë. Dhe këtë konfirmim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të institucioneve të Republikës së Kosovës më së miri e ka konfirmuar edhe dje e nderuara sekretare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Klinton. Pra, shteti i Kosovës do të ketë bashkëpunim ndërshtetëror me Serbinë, si me gjitha vendet e tjera të rajonit, në interes të shtetit të Kosovës, në interes të pages, të

bashkëpunimit rajonal, të stabilitetit dhe të integritetit të vendeve tona në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Ky është vizioni ynë, ky është edhe qëndrimi i Uashingtonit dhe i Bashkimit Evropian. Prandaj, do të ecim bashkërisht në këtë rrugë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Deputet, ke pyetje shtesë? Fjala, deputetit Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Unë pyetjen ia kam drejtuar zëvendëskryeministrit. Kjo mendoj që është një shkelje e Rregullores së Kuvendit. Ia kam ditur emrin edhe kryeministrit, prandaj kisha lutur që herëve tjera të përgjigjet vetëm personi prej të cilit kërkojmë përgjigje. Megjithatë, kryeministri edhe këtë rast e shfrytëzoi për në fushatë që e ka filluar këto ditë, le të vazhdojë kështu! Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministrit, fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk dëshiroj të përzihem në çështje elektorale, as në debate të tilla, por dëshiroj të theksoj se, ju e dini se kryeministri i një vendi përfaqëson Qeverinë e vendit. Lexo edhe kushtetutën edhe ligjet, edhe drejtën tonë legale, por nëse dëshiron për plotësime shtesë, e ftoj zëvendëskryeministrin që të prezantojë gjithashtu çështje konkrete plotësuese për ju, por sido që të jetë, ne e konsiderojmë dhe e vlerësojmë këtë përgjigje adekuate për ju, i nderuari Kurteshi.

KRYETARI: Faleminderit!
Pyetja dhe përgjigja është kryer. Tani vazhdojmë me të rejat.
Deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin Thaçi apo ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën!

DRITON TALI: Zoti president, unë do të doja që zoti kryeministër të më përgjigjet, se edhe ashtu është shef i Kabinetit, kështu që mos të merrem me zotin Ahmet Shala, se kurrë s'po përgjigjet.

Zoti kryeministër,
Më 15 korrik, zotin Shala, shpresoj nën direktivat e tua, e pata pyetur se çfarë do të bëjë, më fali, 15 korrik të vitit 2008, se çfarë do të bëjë Qeveria për të ndaluar kontrabandën që zhvillohej, zhvillohet edhe më tutje në veri, me theks të veçantë kontrabandën me derivate, ku i pata përmendur dy pompa të benzinës në Mitrovicë, që në fushë të zotit, pa kurrfarë standarde, atë kohë shitnin benzinë me çmim shumë më të ulët.

Zoti ministër, në emër të Qeverisë, pra në emër të juaj, zoti kryeministër, pati premtuar se së shpejti do të zgjidhet ky problem, ku mes tjerash pati thënë, e kemi në transkripto, në faqen 32, se me rivendosjen e kamerave dhe me dhënien e më shumë kompetencave Administratës Tatimore në Ligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat, Administratat Tatimore do të fitojë më shumë fuqi për të konfiskuar prodhimet pa prejardhje. Siç e dini, Ligji për Administratën Tatimore dhe procedurat është në fuqi tashmë 2 vjet, megjithatë edhe më tutje vazhdon kontrabanda, numri i pompave tashti atje është shtuar, nga 2 sa ishin atëherë, janë bërë 10 e më shumë, disa me standarde e disa fare pa standarde. Pyetja është: Kur do të ndalet kontrabanda me derivate të cilat futen dhe shiten në Mitrovicë, mbase kjo nuk është ndonjë pyetje me vend, kështu po them në prag të bisedimeve teknike apo praktike, siç po thoni ju, apo edhe para zgjedhjeve, i kemi zgjedhjet. Po them, sepse para disa muajve pate ndaluar që të bisedohet në Kuvend për çdo gjë që ka të bëjë për këto zgjedhje praktike apo teknike, më patët qortuar kështu ashpër pse bëra disa pyetje. A na jepni përgjigjen, kur do ta ndalni kontrabandën, a mbani...

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari deputet Tali,

Unë vazhdimisht ju kam inkurajuar për pyetje edhe për debat dhe vlerësoj përkushtimin e çdo deputeti në këtë drejtim që të gjitha temat të diskutohen në Parlamentin e Kosovës.

Siç edhe e dini, unë kam deklaruar edhe më herët se kontrabandistët dhe njerëzit e strukturave ilegale i kishin ditët e numëruara dhe tani ka filluar të veprojë ligji. Tani atje kemi një angazhim më konkret të KFOR-it, të EULEX-it dhe të strukturave të Policisë së Kosovës, pra të autoriteteve vendore. E kemi hapur Zarën e shërbyesve civilë, që u shërben edhe shqiptarëve, edhe serbëve të Republikës së Kosovës dhe, në anën tjetër, jemi të përkushtuar të vazhdojmë me sundim të ligjit për implementimin e plotë të Strategjisë për veriun, pra për integrimin në kuptimin edhe etnik, por edhe territorial. Do të vazhdohet të punohet për formimin e komunës së re dhe organizimin e zgjedhjeve të lira në tri komuna të tjera dhe kemi investuar, vetëm në dy muajt e fundit kemi ndarë mjete mbi 10 milionë euro për të investuar për një jetë më të mirë të të gjithë qytetarëve edhe në atë pjesë të Republikës së Kosovës. Pra, kanë filluar atje arrestime ndaj kontrabandistëve, ndaj njerëzve të krimit të organizuar dhe ndaj njerëzve të strukturave ilegale. Unë ju siguroj juve, të gjithë deputetët dhe qytetarët e Republikës së Kosovës se këto angazhime nuk do të ndalen.

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

DIRTON TALI: Faleminderit, zoti president!

Zoti kryeministër, nuk m'u përgjigje. Pyetja ishte kur do të ndalet...? Keni premtuar para 2 vitesh që do ta ndalni kontrabandën. Përsëri po them, pyetja ishte për hajni, për kontrabandë, nuk ishte politike, jo për këtë farë involvimit të minoritetit serb. Këtu kemi të bëjmë me disa hajna që shumë mirë bashkëpunojnë mes shqiptarëve dhe serbëve. Halli im është se mos me ato para të kontrabandës do të blihet posta, mund të jetë edhe ajo, prej atyre parave, se po e di që shumë parti politike financohen prej kontrabandës, kështu të paktën thonë burimet e inteligjencës, qofshin amerikane, qofshin të huaja, por a do të futen ato para në post, mund të jetë ajo?!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju e dini se çështjet nuk rregullohen... Fillimisht, që të kemi stabilitet, që të kemi rend, që të kemi demokraci, që të kemi mundësi të njerëzve për t'i zgjedhur njerëzit e vet legjitim, duhet të funksionojë ligji. Ne të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm për deformimet që kanë ndodhur në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, po në të njëjtën kohë gjithë kanë qenë të vetëdijshëm, e në të njëjtën kohë të njohur, për përkushtimet dhe zotimet e vendosmërinë të pashoqe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rikthimin e rendit dhe të ligjit në veri të Mitrovicës dhe, në anën tjetër, të gjitha këto probleme të zgjidhen përmes ballafaqimit me ligjin dhe ata që e shkelin ligjin, të ballafaqohen me ligjin, të dalin para organeve të drejtësisë. Jemi duke punuar për hapjen e gjykatës sa më shpejt që është e mundur, ndërsa unë nuk dëshiroj të ngrejë çështje që i takojnë një konspiracioni, që unë nuk besoj që mund ta konfirmosh, të thirrrem në ato burime që po i përmend, as ju, as nuk e di se kush mund të thirret në ato burime. Por, në të njëjtën kohë dëshiroj të theksoj se do të vazhdojmë të jemi të pakompromis kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, pra për vënien e rendit dhe të ligjit në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës dhe të gjithë kontrabandistët, të gjithë shkelësit e ligjit nuk do të kenë angazhime të rehatshme. Përkundrazi, do të

kenë ballafaqim me ligjin, kudo qofshin, edhe në veri e, besa, edhe në vendet tjera. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,

Unë këtë pyetje e kam bërë edhe disa herë, por ju nuk ishit këtu, kështu që kam qenë i detyruar ta përsërisë pyetjen në mënyrë të vazhdueshme, është hera e tretë që bëjë një pyetje të tillë, pyetjen që ka të bëjë me barërat. Besoj që është shumë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës ta dinë realitetin se çka me të vërtetë ka ndodhur në Ministrinë e Shëndetësisë për këto vitet e fundit gjatë kësaj qeverisje, ndoshta edhe në qeverisjet paraprake? Po, sidoqoftë, qytetarët janë të interesuar të dinë për shëndetin e vetë. Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë shumë herë deklarojnë se gjatë procesit të blerjes së barërave buxheti i Kosovës është dëmtuar rëndë. Këto janë deklaratat zyrtare të zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe pyetja ime është e orientuar - pse nuk keni bërë publik se për sa është dëmtuar buxheti i Kosovës gjatë blerjes së barërave dhe sa janë vlerësimet e juaja paraprake të dëmtimit që i është bërë buxhetit të Kosovës? Unë, sipas të dhënave që disponoj, këto janë të dhëna të verifikuara nga Ministria e Shëndetësisë, domethënë një komplet i të dhënave, ku përcaktohen blerjet emergjente, blerjet emergjente të barërave që ndoshta edhe nuk janë emergjente. Çmimi i këtyre barërave shpeshherë tejkalohet disa 100% më shumë se sa, për shembull, kushton në Britaninë e Madhe, sipas British national formulary, ku mendoj që statistikën, standardi dhe kualiteti i barërave në Britaninë e Madhe e tejkalon shumëfishë, mos të përmend edhe skadencën e barërave. Për shembull, këto janë të dhëna që janë të konfirmuara nga Ministria e Shëndetësisë, disa prej barërave që në Britaninë e Madhe kushtojnë 1.5, në Kosovë kushtojnë 2.9 edhe me blerje me shumicë. Kjo automatikisht ne na reflekton se aty ka parregullsi të mëdha, që i involvojnë strukturat e larta të shtetit...

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, në pyetjen, për të cilën me keqardhje e them se sigurisht mungesa ime ka qenë, nuk i kam ikur, nuk i jam shmangur kësaj pyetjeje. Kështu, prej momentit kur unë e kam marrë detyrën në këtë ministri, lidhur me këtë çështje kam themeluar një komision, i cili përveç planifikimit vjetor për furnizim, ka marrë për detyrë që të vlerësojë edhe t'i krahasojë çmimet e barërave dhe të materialit shpenzues, me të cilat furnizohet Ministria e Shëndetësisë. Komisioni ka bërë aty analiza, ka qenë një komision i mirë dhe ka dhënë rekomandime. Krahas shumë këtyre çështjeve dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me financimin e furnizimit me barëra, vlerësimit të nevojave reale, kontrollimit të shpenzimeve të ministrisë, ky komision ka evidentuar edhe një, ta them kështu, t'ia fillojmë butë, një mospërputhshmëri ose një diskrepancë në mes të çmimeve të blerjes për disa lloje të barërave. Pas marrjes së mendimit të këtyre ekspertëve, Ministria e Shëndetësisë ka ndërprerë kontrata, shumë kontrata për furnizim me ato kompani të cilat kanë ofruar material jo kualitativ, barna jo kualitative me prejardhje të dyshimta, si është Kina, për shembull, India, dhe me ato kompani të cilat kanë dhënë çmime, të cilat ne i kemi konsideruar, edhe ju me të drejtë i konsideroni se janë skandaloze. Ne i kemi krahasuar, natyrisht, ato çmime me çmimet referente të kontraktuara vitet e kaluara me formularin nacional të Mbretërisë së Bashkuar dhe me çmime referente të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Kështu, ne tani, natyrisht, po bëjmë përpjekje që këto materiale të dyshimta t'i eliminojmë nga furnizimet në të ardhmen, duke vendosur kritere gjatë tenderimit. Këtu është ajo poenta tani. Problem i madh është tenderimi për të siguruar material kualitativ dhe të furnizohet Ministria e Shëndetësisë, por edhe për t'iu shmangur furnizimeve tjera që, ju e dini, Ministria e Shëndetësisë bën një pjesë, një pjesë në furnizim, ndërsa ato vinë edhe nga barnatoret private. Ta përfundoj ose të përpiqem ta kompletoj. Natyrisht që është një lëmsh, ka qenë

edhe është edhe më tutje lëmsh i madh në furnizimin e barërave. Kemi probleme me struktura mafioze ala të kartelit ...

Drejtimitin e seancës e merr zoti Xhavit Halitii, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit!

Keni pyetje shtesë? Zoti Rrustemi, pyetje shtesë.

NAIM RRUSTEMI: Po, kam pyetje shtesë.

Unë, më shumë jam i orientuar dhe i fokusuar se kur Ministria e Shëndetësisë do të bëjë publike emrat e gjithë atyre të involvuarve në mafiozitetin e tyre, siç e quajti ministri grupin mafioz, se këtu po shihet qartë që është krim i organizuar i shumë strukturave formale dhe joformale në tregun e barërave, kur do të bëhen publike dhe a do të filloni ndonjë procedurë që njerëzit që janë të involvuar në këtë krim të organizuar, të ndjejnë dhembjen, dhembjen për të këqijat që ia kanë sjell këtij vendit. Ke parasysh që po flasim për shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Kur dhe a do t'i bëni publike gjetjet e juaja nga Ministria e Shëndetësisë dhe a premtoni se do të ndjejnë dhembjen për bërata e këqija që ia kanë sjellë qytetarit të Kosovës, ku populli i Kosovës për çdo ditë ballafaqohet me problemet e veta në fushën e shëndetësisë, shkon në Qendrën Klinike Universitare, barërat esenciale mungojnë. Pyetja ime është konkrete, kur...

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Edhe këtu nuk shoh ndonjë problem, po mendoj se duhet të respektohet një rend. Këto parregullsi ose këto indicione për mafiozitet, po them, natyrisht janë paraqitur edhe janë denoncua në organet përkatëse ose, të them, në EULEX, në prokurori e tjera, janë gjërat në procedurë dhe presim, pra, më së pari, do me thanë mos ta marrim rolin e prokurorit, të gjykatësit dhe të gardianit të burgut. Por, ju siguroj se nuk do të ketë këtu kurrfarë shmangieje apo mbulimi. Nuk është kjo sekret, kjo është çështje publike dhe kjo do të publikohet. Do t'i presim këto rezultate, si të them, ose rezultate të investigimeve. Për këtë ju kisha lutur të kemi ndoshta edhe pak durim, deri sa të kryhen. Ato po zgjasin po, siç thuhet, drejtësia është e ngadalshme, por dikur triumfon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime është kërkesë e mërgimtares tonë, zonjës Pireva, e cila jeton në Zelandë qe 15 vite me familjen e saj. Ajo thotë se jo vetëm që nuk ka gjetur përkrahje te institucionet, por as nuk po mund t'i realizojë të drejtat e saj. Familja posedon të gjitha dokumentet valide që është pronare e një banese në Prishtinë, e cila është uzurpuar që nga paslufta dhe me gjithë padinë që e ka bërë, asgjë nuk është ndërmarrë, ka mbetur në sirtarë, kurse familja dëshiron të kthehet në atdhe, në Kosovë. Zoti Pireva ka magjistruar si farmacist klinik në Universitetin Auklan, të Zelandës, dhe gjithashtu ka dëshirë edhe vullnet që të kontribuojë në Kosovë me dijeninë dhe përvojën të cilën e ka marrë në Zelandën e Re. Fatkeqësisht, institucionet nuk po ia hapin dyert.

Zoti kryeministër,

Çfarë do të bëni ju, si kryeministër, për këtë familje mërgimtare dhe për mërgimtarët në përgjithësi për të siguruar, ashtu siç keni premtuar, përkujdesje për mërgimtarët? Faleminderit!

KRYESUESI: Unë mendoj që s'është pyetje për kryeministrin fare kjo, por hajt!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Me respekt, Gjylnaze, por mendoj që pyetjet e tilla duhet t'ua drejtoni organeve kompetente dhe jo kryeministrin, po gjykatave, organeve të drejtësisë dhe ju, besoj që e dini. Mirëpo, sa i përket mërgatës në përgjithësi, më lejoni që mund t'ju përgjigjem, nëse ju keni disponim, natyrisht nëse ka disponim edhe Parlamenti, po për çështje konkrete ju kisha ftuar që t'iu drejtoheni organeve kompetente.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputete, dëshironi pyetje shtesë? Deputetja Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryesues,

Unë në fillim e ceka që zonja Pireva ka kërkuar t'ia bëjë këtë pyetje Qeverisë, kjo është e para dhe unë e respektoj vullnetin e saj.

E dyta, ju jeni përgjegjës për reformat në drejtësi, domethënë, nga aspekti i buxhetit nuk është se nuk keni përgjegjësi në këtë aspekt.

Dhe, e treta, ne e kemi kaluar Ligjin për mërgatën dhe Ligji për mërgatën thotë se duhet të kërkohet, promovon në të vërtetë më shumë fuqizimin e lidhjeve në mes të mërgatës dhe të institucioneve të Kosovës. Në këtë aspekt u shtrua edhe pyetja ime të cilën, si duket, kryeministri s'e kuptoi. Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Mirë, në këtë drejtim do të kesh edhe përgjigjen.

Prona private është e paprekshme, është e shenjtë dhe unë jam në mbështetje të plotë. Sa i përket pyetjes tuaj shtesë tash, politike, që e ngarkove, lidhur edhe me pronësinë e bashkatdhetarit të nderuar, Pireva, dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovë nuk është përgjegjëse për çështje të zgjidhjes së kontesteve individuale pronësore. Unë besoj që ju personalisht e dini, nëse s'e dini, mësojeni! Por, në të njëjtën kohë, ne si Qeveri kemi Agjencinë për mërgatën, e cila është përgjegjëse për përkujdesjen dhe mbrojtjen e interesave të mërgatës. Në asnjë rrethanë nuk do të lejoj që të ndikojë tek organet e drejtësisë apo gjykatat.

Sipas informacioneve që kam, e nderuara Sylja, në rastin në fjalë, familja Pireva duhet të lajmërohet në Agjenci, e cila do të mund ta këshillonte këtë familje se ku duhet të drejtohet për çështjen e kontestit të pronës. Ndërsa, sa i përket punës së Qeverisë në lidhje me mërgatën, Qeveria ka ndërmarrë shumë aktivitete, siç janë..., ndërsa familjen Pireva e ftoj që të takohemi dhe do të jem në mbështetje dhe do t'i ndihmoj me të gjitha mundësitë, kapacitetet e mia, edhe individuale, dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sa i përket mërgatës, është miratuar Ligji për mërgatën, i cili ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2010. Në bazë të këtij ligji, Zyra e mërgatës është ngritur në Agjenci për mërgatën e Kosovës. Gjatë këtij viti po ashtu janë realizuar shumë projekte në lidhje me mërgatën, ndër të cilat janë: hapja e ekspozitës tematike "Amerika për Kosovën", është një ndër projektet më të rëndësishme që ka bërë Zyra e kryeministrin. Ky projekt pasqyron kontributin e madh të mërgatës shqiptare dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ka dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Manifestimi tashmë tradicional - "Ditët e mërgatës", që nga viti 2007 mbahet enkas për mikpritjen e bashkatdhetarëve gjatë kohës së pushimeve të tyre, që ata i kalojnë në atdheun e tyre, në Kosovë.

Pastaj, përgatitet terreni për hapjen e qendrave kulturore në vendet mikpritëse të mërgatës, hapja e bibliotekave në mërgatë dhe furnizimi i tyre me tituj të ndryshëm të librave, krijimi i bazës së të dhënave “Mërgimtari”, regjistrimi i organizatave, shoqatave, bizneseve e tjerë. Krijimi i një WEB sajti enkas për mërgatën, ku mund të informohen për të arriturat e vendit tonë dhe njëkohësisht të shprehin kërkesat e tyre, si dhe të bëhet promovimi i vlerave të mërgimtarëve. Programe të veçanta për mërgatën do të transmetohen në Radiotelevizionin e Kosovës, e nderuara deputete. Botimet me vlera të veçanta nga mërgata i kemi mbështetur deri më tani dhe vazhdojmë t’i mbështesim. Jemi në përpilim të sipër të hartimit të planit për Strategjinë kombëtare për mërgatën, Agjencia e mërgatës, Zyra e kryeministrit është urë lidhëse e mërgatës dhe të institucioneve tona shtetërore të Kosovës, në bazë të kërkesave të tyre orientohen në vendin e duhur. Agjencia për mërgatën, Zyra e kryeministrit, pra, është bashkë organizator i shumë konferencave që kanë të bëjnë me investimet në Kosovë.

Ndërsa, dëshiroj edhe një herë publikisht të ftoj në zyrën time familjen Pireva dhe çdo mërgimtarë që është i interesuar për t’u takuar dhe për të pasur mbështetjen time të përkujdesjes dhe të të gjitha institucioneve për problematikat të cilat i kanë. Faleminderit, shumë! Por gjithmonë, duke mos pretenduar për të ndërhyrë tek organet e drejtësisë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Abdyl Ymeri, për ministrin..., ministri s’është. A doni ta parashtroni pyetjen, apo jo? Jo! Pastaj, deputeti Riza Smaka, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi apo zëvendësin Hajredin Kuçi. Zoti Smaka, e ka fjalën!

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryeministër ose eventualisht zëvendëskryeministër, cilido që jepni përgjigjen,

Ministria e Administratës Publike e ka Bazën informative për automjetet zyrtare dhe e mban në mënyrë korrekte atë, madje ka bërë atë që ka mund ta bëjë në mënyrë që të gjitha ministrinë t’ia japin të dhënat e sakta për auto veturat zyrtare, siç e dimë, të cilat nuk janë të lira apo jo. Vetëm 5 ministri të Qeverisë e kanë përfillë këtë obligim themelor elementar. Numri më i madh i ministrive këtë e ka shpërfillë, kështu që sot për sot, aktualisht në këtë çast Qeveria nuk ka të dhëna se sa automjete zyrtare i ka, mos të flasim për amortizimet, mos të flasim për dëmtimet, madje mos të flasim edhe për disa humbje të disa auto veturave zyrtare jo të lira, të cilat fare nuk ekzistojnë në evidencë. Ja ku e kemi edhe Projektligjin për kontabilitetin, shpresoj që do të miratohet, por kemi edhe tash rregulla për kontabilitetin. Pse është kjo gjendje e këtillë, ju lutem? Kjo është një punë e thjeshtë. Unë e di se kjo nuk bëhet me lejen e juaj, kështu besoj, por neglizhenca e personelit që është i punësuar kryesisht nga ju, po ndoshta edhe nga të tjerët, domethënë. Ju lutem, kjo çështje madhore, ndryshe, se është paraja publike në pyetje, asetet publike dhe nuk është mirë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Kuçi, e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër, ministra,

I nderuari deputet, profesor Smaka,

Ju falënderoj për pyetjen që keni bërë, që është jashtëzakonisht me vend, e cila ka edhe përmbajtjen për një çështje të cilën edhe si Qeveri e kemi menduar disa herë.

Në fillim të mandatit kemi nxjerrë një udhëzim administrativ, që ka pasur për qëllim kufizimin e shpenzimeve të tepërta dhe po ashtu ka pasur për qëllim një lloj kontrolli të shfrytëzimit të automjeteve dhe të mjeteve të tjera, aseteve që gjenden në Qeverinë e Kosovës. Pasi kemi nxjerrë një

udhëzim të tillë administrativ, ka pasur një respektim të duhur, por jo në shkallën çfarë e kemi dashur ne dhe sot e kësaj dite mund të themi se nuk respektohet ashtu si duhet dhe shpeshherë mund ta vëreni, ndoshta më shumë mund të respektohet nga zyrtarët e lartë të Qeverisë, se sa nga të tjerët. Udhëzimi administrativ parasheh edhe masa ndëshkuese për të gjithë ata dhe unë po them që kemi dërguar letër direkte, pasi e kemi marrë pyetjen nga ju e kemi dërguar edhe një letër, zoti profesor, edhe ministri i Administratës Publike dhe kemi ardhur në përfundim se ka nevojë që të zbatohet një sistem elektronik të kontrollimit të shpenzimeve të automjeteve, që duhet të besoj që ky do të hyjë në fuqi para përfundimit të këtij viti. Por, në çdo rast unë ju ftoj juve dhe qytetarët e Kosovës që në momentin e caktuar kur hetohet një keqpërdorim i tillë, të jetë pjesë e reagimit edhe qytetar, edhe në institucionet e vendit, por edhe të organit kompetent të Policisë apo diku tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!
Zoti Smaka, a dëshironi pyetje shtesë? Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Po, faleminderit!
Falënderohem për përgjigjen konkrete dhe kompetente!
Pa keqkuptime, do të kisha aluduar që në vend të letrës tash, domethënë, ndoshta edhe sot të jepni një urdhëresë për hapjen e procedurës disiplinore dhe materiale kundër të gjithë atyre bartësve të detyrave themelore që nuk i kryejnë në disfavor të parasë publike, të aseteve publike, se këto çështje zakonisht nuk kryhen edhe s'mund të kryhen, sidomos në milein tonë, në ambientin tonë, me lutje, me kërkesa, si të them, pa ndërmarrje të masave ligje, s'po them drakonike, s'po them drastike, masa ligjore. Ju falënderohem, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Smaka, pyetje për ministrin Zharku.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Auditor i nderuar,
Aktualisht, në vendin tonë përpjesëtimisht vetëm një inspektor mbikëqyrë 700 subjekte afariste dhe 8 distributorë tregtarë të arit, të metaleve të çmuara. Rrjedhimisht, edhe dyshimet e pashmangshme dhe të bazuara për kontrabandimin e arit, për evazionin tatimor dhe për qarkullimin e tij me vlera të dyshimta. Në këtë kontest, vlen për ta theksuar edhe vakuumin juridik në Ligjin për metalet e çmuara, i cili konsiston në papërcaktimin e masës së përkohshme të sekuestrimit të metalit të çmuar ne posedim dhe përdorim të dyshimtë. Kjo mangësi pa dyshim kontribuon edhe në inefikasitetin edhe në inefiçencën e autoriteteve të MTI-së, Departamentit të Metrologjisë, jo të Meteorologjisë, po Metrologjisë në ushtrimin kompetent të funksioneve referuar inspektimit dhe monitorimit legal të qarkullimeve dhe të përdorimeve të metaleve të çmuara. Kalimthi e them, ari i Kosovës nuk pranohet në asnjë shitore në botën e jashtme, sepse apriori konsiderohet i dyshimtë. Kjo është edhe si pasojë, na humb edhe imixhin tonë si shoqëri politike ose, bie fjala, ndokush do të thoshte mungesë ligji, po nëse është mungesë ligji, ministria është për këtë çështje për ta iniciuar menjëherë ndryshimin dhe plotësimin e aktit ligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Bukoshi.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Më fal, më fal. Ministri e ka fjalën për përgjigje. Më fal zoti ministër, thashë mos e kreu krejt.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuar profesor Smaka,

Një ndër obligimet e Departamentit të Metrologjisë në bazë të Ligjit 2004/28 për përpunime nga metalet e çmuara është edhe kontrollimi i cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara, të importuara dhe të prodhuara në Kosovë, e që ka të bëjë me përshtatjen e prodhimeve dhe shitjen e punimeve nga metalet e çmuara me standarde ndërkombëtare ISO 9202, sa i përket përbërjes dhe përmbajtjes, gjegjësisht pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara, kontrollimit dhe shënimit të punimeve që vihen në qarkullim, si dhe mbrojtjen e prodhuesve dhe të blerësve të punimeve nga metalet e çmuara prej keqpërdorimeve të mundshme. Edhe pse kjo fushë shumë e rëndësishme nuk ishte e kontrolluar që nga paslufta, në vitin 2008 kemi hartuar 3 akte bazë nënligjore, të cilat rregullojnë këtë fushë, e ato janë: Udhëzimi 2008/4 për caktimin e tarifave të përshtatshmërisë së punimeve nga metalet e çmuara, Udhëzimi 2008/6 për shenjat e prodhuesit, punuesit dhe shitësve të punimeve nga metaltë e çmuara, Udhëzimi 2008/7 për formën dhe përmbajtjen e shenjave të pastërtisë, mënyrën e përcaktimit dhe shënimit të shkallës së pastërtisë të punimeve nga metalet e çmuara.

Bazuar në këto udhëzime, gjatë kësaj periudhe kohore Departamenti i Metrologjisë, në bashkëpunim me Inspektoratin e Tregut ka arritur të licencojë shumicën absolute të subjekteve që merren me këtë veprimtari, respektivisht t'i pajisë me vendime, foto - vula dhe vula identifikuese konform legjislacionit në fuqi. Krahas kësaj, Departamenti i Metrologjisë në bashkëpunim me Inspektoratin e Tregut ka zhvilluar edhe kontrollin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara. Natyrisht, bazuar në Ligjin e deritashëm në fuqi mbi Inspektoratin e Tregut, fusha e inspektimit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare ka qenë në kompetencë të inspektorateve komunale.

Departamenti i Metrologjisë së Kosovës, siç e përmendët, aktualisht ka një zyrtar metrolog për kontrollin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara, si dhe një laborator për analiza kimike në Prizren. Duke qenë të vetëdijshtë për rëndësinë e kësaj fushe, ne kemi kërkuar që me buxhetin e vitit të ardhshëm të na lejohet rritja e numrit të zyrtarëve në Departamentin e Metrologjisë, bazuar në Projektligjin për metrologjinë, i cili ka kaluar në leximin e parë në Kuvend.

Gjatë këtij viti kemi pajisur Laboratorin Qendror të Metrologjisë me pajisje shtesë për laboratorin e metaleve të çmuara. Po ashtu, për vitin 2011 kemi paraparë amendamentimin e Ligjit për punime nga metalet e çmuara, me qëllim të evitimit të mangësive që janë shfaqur në praktikë gjatë implementimit të tij, e të cilat i përmendët edhe ju. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, deputet? Zoti Smaka, e keni fjalën.

E ka fjalën Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I falënderohem ministrit të nderuar, Zharku, për përgjigjen kompetente dhe serioze, po dëshira ime është që këto të bëhen, të realizohen sa më parë që është e mundur, medoemos ka vend dhe ka nevojë për buxhet, për financimin e një numri më të madh të inspektorëve se ata edhe ato pagat e tyre do t'i kishin kompensuar në mënyrë elegante. Po e zëmë sekuestrimi, ju lutem, sekuestrimi i sasive të mëdha të arit, po e zëmë, që kontrabandohet, që aty do të kishte vend për

kompensim kompetent të pagave, të kompensimeve edhe të atyre edhe të tjerëve edhe do të ndalej ky proces i dëmshëm edhe për ekonominë e tregut edhe për imazhin e vendit tonë.

Ju faleminderit, zotëri ministër!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Tali, pyetje për ministrin Bukoshi. Bukoshi doli.

Zoti Tali, a dëshironi fjalën?

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I mbeta borxh edhe zotit kryeministër për disa shifra që i dhashë. Qeveria mund ta konsultojë Institutin e Paqes në SHBA, Rutgers Institute SHBA, e mos t'i numërojë të gjitha, pra janë këto institute të rëndësishme të SHBA-ve, të cilat në vazhdimësi na ndihmojnë ta luftojmë korrupsionin dhe krimin, për çka edhe duhet t'u falënderohemi. Sidoqoftë, të kthehem te pyetja. Pyeti se ku i kam marrë informatat për atë pyetjen që e bëra? Informatat janë këtu, po ka edhe institucione tjera.

Por, sidoqoftë pyetja për zotin Bukoshi është edhe më tutje ajo e moçmja, që nuk po marr përgjigje. Ka të bëjë me listën e atyre të cilët e kanë uzurpuar, por edhe të atyre që e kanë shpronësuar pronën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Flasin për 6 hektarë tokë, pronë publike të Qendrës Klinike Universitare, të cilën e kanë uzurpuar personat e pandershëm, të papërgjegjshëm të cilët kanë qenë, dyshohen shumica e tyre si bartës të institucioneve. Zoti Bukoshi pati premtuar më 25 qershor se emrat, ja ku e kemi, tash erdhi, se emrat e personave publikë të cilët e kanë uzurpuar pronën publike, do t'i bëjë publike, pra do të na tregojë kah shtatori, tash jemi më 14 tetor. Bile po e citoj, pati thënë se do t'i publikojë emrat, pa paragjykitje, pra të gjithë ata individë të cilët kanë keqpërdorur pronën publike, pa marrë parasysh se cilave subjekte politike u takojnë. Një premtim të tillë e ka dhënë edhe drejtori i Qendrës Klinike Universitare, i cili pat thënë se së shpejti do ta bëjmë publike listën e të gjithë atyre të cilët e kanë shpronësuar apo tjetërsuar pronën e Qendrës Klinike Universitare.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bukoshi.

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Po, zoti Tali. Unë jam edhe më tutje në pritje të informatës për shfrytëzuesit ose uzurpuesit e këtij territori, domethënë, emrat e shfrytëzuesve. Ju e dini se nuk i kemi ende emrat për shkak se unë po pres se drejtori aktual i Qendrës Klinike Universitare, i cili pat një ndërprerje për arsye të njëfarë hallakame aty që ndodhi, ai është rikthyer në vendin e punës në bazë të këtyre rregullave dhe i ka plotësisht duart e lira ta kryejë këtë punë, ne e presim këtë informatë. Mos t'i përsëris gjërat, nëse pajtoheni se e kemi dhënë këtë historikun e dokumentacionit të kadastrës e tjera. Në bazë të situacionit tash që u punua nga Drejtoria e Kadastrit të Kosovës, shihen, konstatohen ndërtime të mëvonshme, pasi janë uzurpuar, por nuk ka emra të shfrytëzuesve. Kjo është përgjigja ime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Thaçi dëshiron të inkuadrohet në përgjigje, sepse ishte për të dytë? OK.

A dëshironi pyetje shtesë për ministrin?

E ke fjalën!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Ministër, pyetja domethënë ka të bëjë për ata të cilët e shpronësuan, e tjetërsuan, pra e vodhën pronën, është një çështje tjetër, janë rreth 6 hektarë, dikush thotë 10 hektarë, 5 hektarë e tjera, e tjera, dhe po ashtu e uzurpuesve. Siç e dini, ka një numër të madh brenda QKUK-së, restorante, barnatore të cilat nuk e kanë qartësuar të drejtën e tyre legale dhe unë e ftoj edhe drejtorin e QKUK-së që premtimet të cilat i bën në publik, le t'iu mbetet besnik, mos të na japin fjalë se jemi ngirë llafe.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën, ministrit!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Po tani këtu është puna, janë konsekuenca logjike të kësaj pune, domethënë, për momentin drejtori aktual i QKUK-së, e ka për obligim ta kryejë këtë punë, gjegjësisht t' i identifikojë me emra dhe kjo është obligim, është detyrë. Nëse nuk e kryen këtë detyrë, a e dini ju çka më mbetet mua, prapë në Komision disiplinor, por kësaj radhe jo të shkallës së parë, por të shkallës së dytë.

Unë e kam për obligim si ministër, e marr këtë obligim që atyre të ndërvuarurve të mi t' i kryejnë punët sikur që zoti Thaçi, nuk di a është këtu, nëse nuk i kryej punët, ky më qet prej pune. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti kryeministër, e doni fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet,
Pasi që u ndërlidhët me përgjigjen time në pyetjen tuaj, pastaj shtesë, unë i lexoj të gjitha raportet dhe përkushtimi im ka qenë, është dhe do të mbetet shumë i vendosur për luftimin e korrupsionit, krimin të organizuar dhe të gjitha fenomeneve negative, pra përkushtimi për qeverisjen e mirë, të sundimit të ligjit, një qeverisëse efikase, një qeverisje që meriton qytetari i Kosovës.

Unë dua të them shumë sinqerisht ndihem shumë krenar kur e gjithë bota i vlerëson të arriturat e jashtëzakonshme të Republikës së Kosovës. Prandaj, unë i kuptoj opinionet ndryshe dhe i respektoj, por në të njëjtën kohë dëshiroj të theksoj se ky përkushtim në luftë kundër korrupsionit do të jetë, qoftë në nivel politik, qoftë në nivele ekonomike apo të administratës, por më lejoni që të ngre edhe një çështje tjetër se lufta kundër korrupsionit do të zbresë edhe në Kuvend, sidomos këtu ju drejtohem juve, të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, që kanë votuar për të zgjedhurit e tyre, e që pastaj, qoftë në një formë apo formën tjetër, janë trafikuar nga një bankë në bankën tjetër, nga një mjedis në mjedisin tjetër. Pra, këtu i vjen era korrupsion dhe në raste të caktuara edhe votimi me elemente të ndikimit të korrupsionit. Prandaj, institucionet relevante përkatëse, do të fillojnë, natyrisht përkushtimet e tyre të shikohet edhe e gjithë puna, angazhimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, autoriteteve të Qeverisë, të politikës kosovare, që të kemi një politikë të pastër të njerëzve që respektojnë vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe jo që trafikojnë për interesa materiale, apo luajnë me vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. E ke kryer. Atëherë, deputeti Ymeri për ministrin Hoxhaj. Ministri nuk është këtu.
E fundit është deputetja Gjylnaze Sylaj, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, kryesues!

Paraprakisht ju kërkoj juve që ta zbatoni rregullën 45, pikat 5 dhe 8. Kanë të drejtë qeveritarët të përgjigjen vetëm 3 minuta në pyetjen e parë dhe pyetjen shtesë, 2 minuta. Edhe ju, edhe kryetari duhet ta zbatoni këtë rregull, mos të flasin në pafundësi qeveritarët, kurse deputetëve ju ndërpritet, pas 2 minutave.

Pyetja ime ka të bëjë me Fondin Pensional të Kosovës. Sipas strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2010, është paraparë që më 15 shtator të këtij viti, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, të shqyrtohet në Qeveri, ndërsa më 15 tetor në Kuvend. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji dhe kërkesat e pensionistëve, në vazhdimësi, pyetja ime i drejtohet ministrit Rashiq: A është hartuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës dhe kur do t'i procedohet Kuvendit? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Unë dua t'ju informoj se po me këtë rregullore, që të mos e dezinformoni opinionin, Kryeministri ka të drejtë sa herë të dojë ta marrë fjalën, sa herë të paraqitet, do ta marrë fjalën. Ndryshojeni Rregulloren, unë do ta zbatoj Rregulloren. Kjo është Rregullorja e Kuvendit të Kosovës dhe mos spekuloni me fjalë, me opinionin.

Zoti Rashiq, e ka fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Gospodine zameniče premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Poštovana gospodo Syla,

Kao što znate i sami, verovatno... da je posle usvajanja Zakona za izmenu Regulative UNMIK-a 2005/20 i takođe Regulativnog uputstva UNMIK-a 2001/35 za penzioni fond Kosova, mi smo kao Ministarstvo inicirali kao naša obaveza, kompetenca naša, pokretanje tog zakona koji će u skladu sa onim načelima, koja ima Centralna banka Kosova, naći način na koji će osigurati tu jednu štednju, da kažem poseban fond. Od tog momenta, to se desilo pre nekih tri ipo meseca ili 4. pošto jeste bilo u našoj legislaciji za ovu godinu, mi smo sva ona potrebna dokumenta poslali Centralnoj banci. E sad, i posle tri meseca, mi nismo još dobili nazad finalnu njihovu verziju, jer smo mi kao kompetentni, ali tehničku stvar mora da uradi Centralna banka, jer mi apsolutno nemamo posle toga nikakvu tehničku implementaciju, tehnički uticaj na sam jedan zakon, nego samo oni koji ustvari imaju nadležnost za zakonom i do sada, po njihovom objašnjenju, još nije završen prevod i lektura, tako je baš bilo u zvaničnom objašnjenju. Evo, prekjuche su još jednom obećali da će ga dostaviti u toku dana, nisu ga još dostavili. Mi, naravno, ovih dana očekujemo da će doći sigurno. Mi smo već napravili grupu, radnu grupu ministarstava, koja će početi radom od 18. ovog meseca, znači samo je taj neki dokument koji treba doći na čekanju.

Još jednom ponavljam, znači, da je zvaničan razlog objašnjenje sa strane Centralne banke, da još nisu završili prevod i lekturu. Znae i sami da ponekada u jezicima ima dosta grešaka, pa treba prvo da se isprave sami jezici pa onda da se prevede. Prema tome, to je zvaničan razlog. Mi ćemo naravno obavestiti vas ili kog god hoćete kada budemo dobili dokument i kada bude radna grupa počela da radi, tako da ćete imati prilike da znate o svim mogućim daljim koracima Ministarstva. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

A keni pyetje shtesë, deputete?

Deputetja Syla e ka fjalën.

Zoti Ministër, derisa Ligjin nuk e paske mbaruar, se nga vetë Qeveria është caktuar data, domethënë, punën nuk e paske mbaruar ashtu qysh e keni planifikuar, që tregon për planifikim të keq. Nga ana tjetër, edhe normal, moskryerje të punës dhe papërgjegjësi, keni deklaruar në media se pensionet në vitin 2011, do të rriten për 10 deri 25% dhe se janë ndarë mjetet buxhetore, por se kjo do të fillojë në vitin 2011. Në qoftë se ka pasur mjete, pse nuk ka filluar më 2010 kjo apo po e bëni për shkak të fushatës? Dhe, ju kujtoj, nuk e di sa jeni në dijeni se Kryeministri ka pas vënë një memorandum me Shoqatën e Pensionistëve, në kohën kur është dashur të marrë vota se këto projektligje do të kalojnë gjatë mandatit të tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

E ka fjalën ministri Nenad Rashiq.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Dobro, ovo nema baš veze sa prvim pitanjem, ali ja tačno da sam rekao da će u sledećoj godini, ne zbog toga, ne zbog bilo kojih namera, verujte mi, predizborne kampanje, nego baš od samog početka 2010-te, mi smo pričali o tome i više puta je bilo objavljeno, ne samo sa strane ministarstva, nego od starane Vlade, da će, da se razmatra jedno lako povećanje, ono što se može uraditi i mi smo tek u avgustu dobili potvrdu, odnosno saglasnost Međunarodnog monetarnog fonda da će nam dati jedan prostor u budžetu koji će moći i povećati te penzije, E na osnovu toga, kada smo mi počeli sa zakonom, sa faktičkim pripremom zakona, mi smo, ja nikada nisam rekao da će biti toliko povećanja, nego sam rekao da je draft Nacrta zakona u pripremi, i kada bude bio gotov, kada budemo imali konkretno stanje, tada ćemo prezentovati, E sada je zakon, taj zakon je gotov kao draft, a uopšte, znate i sami da, što ste i vi pomenuli, to je sve nezvanično, nema nikakve potvrde u vezi bilo kakvih izvora, prema tome mi samo radimo svoj posao onako kao što smo već rekli.

Planirali smo, dobili smo potvrdu od Međunarodnog monetarnog fonda, i na osnovu dokumentacije, kada smo tehnički završili sam zakon, draft zakona, tad možemo i pričati o njemu. Mi smo sada završili. Poslali smo ga u Ministarstvo ekonomije i finansija na finansijsku deklaraciju i kada budemo imali sve, tada možemo reći da preduslovi su stvoreni, jer ne možemo pričati o nečemu kada nemate već na papiru sve. Ovako, sada kada imamo, možemo početi priču o tome, čak šta više ne tvrditi koji će datum biti siguran kada će ući zakon na snagu, nego pričati o stvarima kakve jesu u tom datom momentu, a to sada jeste tako. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Me këtë konstatohet që koha për pyetje përfundoi.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me procedimin e mëtejshëm. Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare, andaj procedojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është - Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 tetor 2010.

Ne e kemi miratuar rendin e ditës...

(Ndërrhyrje nga salla)

Okej, ne mund të diskutojmë, por po ju them që në bazë të Rregullores, në qoftë se deri në fillim të seancës nuk vjen asnjë mocion i cili kërkon futjen në rend të ditës ose heqjen nga rendi i ditës të ndonjë pike, konstatohet që rendi i ditës është i miratuar dhe rendi i ditës është miratuar në mbledhjen e Kryesisë, bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare. Megjithatë, për t'i respektuar edhe grupet parlamentare edhe deputetët për rendin e ditës, ia jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar, por zotëri Kryeministri po e kërkon fjalën për rendin e ditës. Ju faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar, kryesues,
Nëse do të kemi mundësi të diskutojmë për rend të ditës, unë do të flisja, nëse është në kundërshtim me Rregulloren, atëherë vazhdo me rregullore, por nëse hap debat, do të dëshiroja të flisja në emër të Qeverisë së Kosovës për rendin e ditës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Me Rregullore, unë nuk kam të drejtë të hap debatin, është praktikë, ka qenë deri me tani. E kemi bërë si praktikë që edhe në gjysmë të seancës të propozojmë gjëra të cilat nuk mund të miratohen gjatë seancës. Prandaj, nëse dëshirojmë ta respektojmë Rregulloren, në nenin 42, pikën 2, shkruan: "Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveç se kur në fillim të mbledhjes një ose më shumë grupe parlamentare përfaqësues të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë, ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngrit një çështje të ngutshme dhe kjo e merr miratimin e shumicës".

Kjo është Rregullorja e Kuvendit që e kemi miratuar së bashku dhe po insisto që të mos e shkelim, dhe po vazhdojmë me rendin e ditës. Për secilën pikë, veç e veç, mund të diskutojmë sipas interesave politike ...

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Mendoj që të gjitha grupet parlamentare që kanë fuqi vote, në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës kanë marrë pjesë në mbledhje e kanë miratuar rendin e ditës. Tani, sipas pikave, të gjitha grupet parlamentare mund t'i japin vërejtjet e tyre në pikat vijuese, prej pikës 3 deri në pikën e fundit të rendit të ditës.

(Reagim nga salla)

... Shiko, unë po thirrëm në Rregullore, unë nuk mund të garantoj që dikush tjetër nuk do ta interpretojë diqysh ndryshe këtë rregullore, sepse ne jemi 8 anëtarë të Kryesisë dhe herë pas herë ndryshojnë, pra ndryshon edhe qasja dhe është kompetenca e tij. Por, Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, neni 42, pika 2, e thotë këtë që e thashë. Në qoftë se doni t'ua përsëris, po ua lexoj prapë. Prandaj, unë nuk e kam ndërmend ta shkelë Rregulloren, nëse doni, nëse nuk doni, atëherë ne po luajmë sikur në atë pikën e parë të rendit të ditës që e kemi – deklarime të ndryshme.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 tetor 2010

Të nderuar deputetë,
Pyes, a keni vërejtje në procesverbal?
E ka fjalën Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Flas për segmentet ku është bërë evidencimi i fjalëve të mia. Asnjëherë nuk e kam përdorur as nuk e përdor, as nuk do ta përdor termin “Zoti”, por “zotëri”. Shumë më pengon, mendoj se kam të drejtë, por gjithsesi insistoj në ato pjesë le të shkruhet “zotëri”. Se, nëse do ta miratonim këtë që shumica e përdorin, atëherë zonjave do të duhej t’u thoshim “zote”, “perëndesha” a s’po di se si. Në asnjë gjuhë botërore, në gjuhët e mëdha nuk thuhet “Zoti”, por “zotëri”...

KRYESUESI: Ju po flisni për tanskirptin dhe jo për procesverbalin...

RIZA SMAKA... Jo, për procesverbal, po aty te unë, në fjalët e mia. Nuk kam thënë “Zoti”, por “zotëri”, zotëri, zotëri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Okej, besoj që do ta ketë parasysh administrata. A ka vërejtje tjera për procesverbalin? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 7 tetor 2010.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. Nuk është Ahmet Shala, e presim atëherë, nuk ka autorizuar dike tjetër, apo ka autorizim zoti Kryeministër? Ministri Shala, ose nuk keni autorizuar askënd. Okej. Mirë që erdhi zotëri Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Kërkoj falje, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Në kuadër të strategjisë legjislative për vitin 2010, në mes tjerash, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, ka hartuar edhe Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Jam i nderuar sot që para jush ta paraqes këtë projektligj, i cili është punuar me një përkushtim të madh nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ky trup i ekspertëve, ka ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për kontabilitetin, procedurat e raportimit financiar dhe të auditimit të bazuara në standardet dhe praktikat më të mira duke pasur parasysh edhe specifikat e sistemit juridik të Kosovës. Gjithashtu, në hartimin e projektligji, janë marrë parasysh edhe praktikat e shteteve të rajonit dhe të Unionit Evropian.

Dëshiroj t’ju njoftoj se kjo fushë ka qenë dhe është ende e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/30 për themelimin e Bordit të raportimeve financiare të Kosovës, si dhe regjimit të raportimit financiar të organizatave afariste, rregullore e cila do të shfuqizohet me hyrje në fuqi të këtij ligji. Kjo iniciativë e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, për ndryshimin dhe plotësimin e bazës ligjore të kësaj fushe, ka rrjedhur si rezultat i zhvillimeve të hovshme dhe të gjithmbarshme politike dhe

ekonomike në Kosovë, të cilat kërkojnë domosdoshmërisht kornizë dhe kuadër të ri efikas, modern ligjor.

Projektligji ka për qëllim parësor avancimin e procedurave administrative dhe shtimin e efektivitetit dhe efikasitetit në fushën e kontabilitetit dhe raportimeve financiare, duke përfshirë këtu edhe auditimin. Arsyeja tjetër e nxjerrjes së këtij projektligji, qëndron në shndërrimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/30 në ligj të Kosovës, e cila definitivisht ka mangësi dhe zbrazëtira juridike. Projektligji definon dhe merret me fushat e më poshtme: kontabilitetin, sistemin e raportimit financiar, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit kosovar për raportim financiar, ndalimin e konfliktit të interesit, ndalimin e keqpërdorimit të informatave, përgatitjen e pasqyrave financiare, pra procedurat, rrjedhojat dhe përgjegjësitë, procedurën e auditimit, kualifikimet e kërkuara për kontabilistë të certifikuar si dhe licencimin e auditorëve.

Projektligji, gjithashtu përcakton procedurat për veprim si dhe një regjim të raportimit financiar të shoqërive tregtare. Sistemi ekonomik i Republikës së Kosovës, në zhvillimet e tij të vazhdueshme, ka krijuar nevojën dhe kërkon që të rregullohet në mënyrë shumë efikase fusha e kontabilitetit dhe mënyra e raportimeve financiare të bazuara në standardet dhe praktikatat më të mira të Unionit Evropian. Natyrisht që edhe ky aspekt, zë në vend të rëndësishëm në këtë projektligj.

Të nderuar deputetë,

Ekonomia e Kosovës ka rritje dhe ka bërë progres të madh viteve të fundit dhe kjo në rend të parë si rezultat i politikave adekuate ekonomike, krijimit të ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Një nga barrierat kryesore në çdo vend, por dhe në vendin tonë, drejt tërheqjes së investimeve të huaja, padyshim ka qenë, është dhe mbase mund të jetë mungesa e një sistemi të sigurt të raportimit financiar dhe strukturave të besueshme rregullative. Ne synojmë që përmes një sistemi të mirëfilltë të raportimit financiar, bashkërisht me një sistem të fuqishëm dhe efikas të tatimeve si dhe një strukturë të ligjit për shoqëritë tregtare, të fuqizojmë Kosovën si një vend të favorshëm për të bërë biznes. Kështu do të bëjmë edhe një hap përpara në drejtim të tërheqjes më të madhe të investitorëve të huaj, relaksim të ambientit biznesor në vend, si dhe një hap përpara drejt integritetit evropian dhe përmbytjes së standardeve legislative të këtij Unioni.

Për arsyet e përmendura më lartë dhe nevojën e domosdoshme që të ecim me këtë ligj, unë ju ftoj që ta mbështetni unanimisht, natyrisht, por gjithsesi vërejtjet dhe sugjerimet e juaja do të jenë të dobishme. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtarin e Kryesisë, Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Vazhdojmë me diskutimin për projektligjin. Ftoj përfaqësuesin, kryetarin ose raportuesin nga Komisioni funksional
E ka fjalën deputeti, Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit zoti kryesues!

E tha edhe zoti ministër në ekspozitën e tij rreth këtij projektligji. Unë dua vetëm të shtoj një çështje. Ne, këtë projektligj e kemi refuzuar si Kuvend, më duket, para një viti dhe si Komision kemi dhënë vërejtjet tona në përmirësimin dhe hartimin e këtij ligji. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka marrë në dorë, ka shqyrtuar këtë projektligj sipas Rregullore të punës dhe ka përcaktuar grupin e punës që

do të punojë në këtë projektligj, në mënyrë që ky projektligj të përmirësohet dhe të plotësohet, sepse Komisioni konsideron se prapë kanë mbetur pa u përfshirë një mori vërejtjesh që kanë qenë në atë draftin e parë të cilin nuk e ka miratuar Kuvendi.

Dua t'ju them, zoti ministër, se unë e kam para vetes, se jemi mësuar të themi nganjëherë dy versione, tri versione, e kam versionin e grupit të punës, grupit të vërtetë të ekspertëve të punës që kanë punuar, që kanë qenë të përfshirë edhe të Bankës Qendrore edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar edhe të mekanizmave tjerë të Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me raportimet financiare dhe kontabilitetin. Dhe, versioni që na ka ardhur në Kuvend, ka disa ndryshime që mendoj nuk di nga kush janë bërë, por që shkojnë më poshtë nga ajo që është kërkuar edhe kur është refuzuar si projektligj, prandaj, duhet të shikojmë bashkërisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe me Komisionin që të bëjnë plotësimin e zbrazësive që ka kështu si projektligj.

Rreth disa definicioneve, që thotë këtu: “shoqëritë tregtare”, ne e kemi një ligj për shoqëritë tregtare dhe sinqerisht edhe në atë ligj nuk është e definuar qartë se çka do me thënë “shoqëri tregtare” dhe kush duhet t'i nënshtrohet auditimit dhe raportimit financiar pranë Njesisë të raportimit ose Këshillit të raportimit, prandaj, në këtë drejtim ne nuk duhet të thirremi shumë te etnitetet që duhet të raportojnë te disa ligje tjera që kanë nevojë të përmirësohen, sidomos në përcaktimin e këtyre njësive ekonomike. Unë po dua të përmend vetëm një shembull, në Ligjin për kontabilitet dhe raportim financiar të Shqipërisë, thotë shumë qartë: “Të gjitha njësitë ekonomike, fitimprurëse i nënshtrohen këtij ligji”. Ndërsa, qysh është i definuar këtu, thotë veç shoqëritë tregtare, ndërsa me shoqëri tregtare sipas Ligjit për shoqëri tregtare, shumë njësi ekonomike na mbetin jashtë nevojës së detyrimit të përmbushjes kësaj të drejte ligjore, këtij detyrimi ligjor, detyrimit të raportimit dhe të auditimit.

Për ndryshe, në pjesët tjera është e rregulluar drejtë dhe qartë edhe në kompetencën e Këshillit të raportimit ose edhe në përbërjen e tij që si, dhe detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli të raportimit financiar. Besoj që bashkë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Zyrën Ligjore të kësaj Ministrie dhe të gjitha aktorët që shprehin interes në këtë projektligj, Komisioni për Buxhet dhe Financa do ta kryejë punën e vet me amendamentim sa më të shpejtë dhe ta sjellë këtu në Kuvend. Prandaj, kërkoj që edhe Kuvendi ta miratojë në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Falënderojmë kryetarin e Komisionit, deputeti Gani Koci.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe është i mendimit që ky projektligj duhet të votohet në parim.

Vendi ynë ka pasur nevojë që edhe më herët ta ketë këtë projektligj, sepse rregullon një fushë shumë të rëndësishme i cili ka të bëjë me regjistrimet, raportimet dhe me sistemin e kontabilitetit i cili është shumë domethënës për ekonominë e një vendi. Ne si grup parlamentar, jemi të mendimit se në këtë projektligj duhet të punohet dhe që Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ka mundësitë, i ka kapacitetet për të bërë përmirësime dhe ndërhyrje të duhura në këtë projektligj, në mënyrë që ky të jetë sa më i mirë dhe sa më i zbatueshëm në praktikë. Ato çka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa i theksoi, sepse ky në lidhje me Ligjin për shoqëri tregtare, mendoj se ne si dy komisione,

domethënë, Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion, mund t'i harmonizojë shumë çështje që kanë të bëjnë me këto dy projektligje, meqenëse Ligji për shoqëri tregtare veç është në procedurë, në Kuvend në Komisionin Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion, kështu që grupet punuese do të koordinojnë punët ndërmjet veti, në mënyrë që ligji të jetë sa më i mirë, parandej ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë në parim këtë Projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj dhe mendoj që plotësimi i kësaj infrastrukture ligjore, e cila deri me tani ka qenë e mangët me Rregulloren e UNMIK-ut, mendojmë, pa dashur t'i përsërisim vërejtjet të cilat i dha edhe kryetari i Komisionit, që ne i kemi shqyrtuar të gjitha këto edhe arsyet të cilat kanë bërë që të ripërsëritet ardhja e këtij projektligji në Kuvend, duhet ta përkrahim dhe e mbështesim në parim.

Prandaj, anëtarët tanë në Komisionin funksional, do ta japin kontributin e vet.

Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta përkrahë në parim këtë projektligj dhe pasi që edhe jam anëtar i Komisionit të Buxhetit, do të kontribuojnë në përmirësimin e këtij projektligji dhe që të jetë sa më funksional në praktikë. Atë që desha të them, e thanë edhe parafolësit, sidomos kryetari i Komisionit paraqiti vërejtjet substanciale që është përdorur dhe që kemi shqyrtuar në Komision dhe besoj që Komisioni për Buxhet në bashkëpunim me Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion, do të bëjë vërejtjet kryesore dhe besojmë që ky ligj do të jetë i profeksionuar. Është bërë një praktikë që thuhet se ligji është ekspertë, kanë punuar ekspertë të ndryshëm, do të jetë shumë i zbatueshëm. Unë dua të them vetë në një rast të një vizite në Gjermani rreth auditimit, në një pyetje që i bëja auditorit, i them rekomandimet e juaja sa zbatohen nëpër ministri, më tha: "nuk mund të përgjigjem për arsye se te ne rekomandimet nuk ka ministri dhe nuk guxojnë që mos t'i zbatojnë", prandaj edhe këtu duhet të bëjmë ligje që në të vërtetë të jenë ligje funksionale dhe ligje që në të vërtetë duhet të funksionojnë në praktikë jo vetëm të rritet numri i ligjeve, ndërsa të mos funksionojnë aspak.

Unë kështu që në parim e përkrahim dhe kontributi edhe i imi edhe i Grupit të Aleancës, nëpër komisionet përkatëse, do të jetë i mirëseardhur.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përhëndetje për Kabinetin qeveritar dhe gjithë të pranishmit.

Duke marrë parasysh se Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, është projektligj i cili duhet të harmonizohet definitivisht me Projektligjin për shoqëritë tregtare i cili gjendet brenda Komisionit parlamentar dhe duke marrë parasysh se është i një rëndësie të veçantë për çështjen e investimeve dhe sigurimin e investorëve të cilët do të jenë në Kosovë dhe njëkohësisht do të jetë një sigurim nga vetë Qeveria për njerëzit cilët do të investojnë në Kosovë për përmirësimin e ambientit mjedisor biznesor, atëherë gjithë harmonizimi i këtij projektligji i cili ka qenë deri me tani, edhe u potencua nga Ministri për Ekonomi dhe Financa, i rregulluar me një rregullore të UNMIK-ut, do të bëhet një harmonizim me Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, dhe Telekomunikacion me Projektligjin për shoqëri tregtare, në të cilin kanë ardhur edhe disa komente të cilat mund të plotësojnë harmonizimin me këtë projektligj dhe njëkohësisht mund të them se projektligji, në rast se harmonizohet me dy komisionet, jep mundësinë që të përmirësohet çështja e investimeve, mirëpo njëkohësisht edhe Qeveria të dijë çfarë investitorë po shtinë në Kosovë në bazë të raportimeve të tyre financiare që do të bëhen.

Në përgjithësi mund të them se Grupi parlamentar i AKR-së merr parasysh çështjen e ambientit mjedisor për investime që është shumë i rëndësishëm për Kosovën dhe jep mundësin të gjitha amendamentimet, sugjerimet t'i japë në këtë projektligj, që ky projektligj të marrë ngjyrën sa më të mirë të mundur kur të vjen në leximin e dytë në seancën plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë, me shumë vëmendje ka shqyrtuar këtë ligj, dhe ka parasysh që ky ligj kë një rëndësi tepër të madhe dhe të veçantë në përgjithësi për kontabilitetin, raportimin financiar, auditimin dhe ato të cilat i potencuan kolegët e mi, nuk dua t'i përsërisë, por është e vërtetë që në Kuvend ky ligj ka qenë edhe para një viti dhe realisht Kuvendi e ka kthyer ligjin me arsyeshmërinë se i ka munguar esenca. Dhe fatkeqësisht edhe pas një viti, Qeveria nuk ka arritur ose mendoj se nuk e ka shikuar fare, por ka marrë të njëjtin draft dhe e ka sjellë prapë në Kuvend dhe vërtet kjo nuk është, nuk është në rregull, por megjithatë duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit dhe duke pasur mundësinë që ky ligj mund të përmirësohet përmes Komisionit FunkSIONAL, ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë do të angazhohemi përmes Komisionit FunkSIONAL që të përmirësojmë ose të amendamentohet ky ligj dhe që të jetë në funksion sa më mirë për vendin.

Prandaj, ne si LDD në parim e përkrahim ligjin.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

I Parlamentarna grupa „7+“ je sa pažnjom razmatrala ovaj nacrt zakona, Nacrt zakona o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji i u načelu će podržati ovaj nacrt zakona. Mada se radi o važnom zakonu, tekst zakona je dosta sa velikim brojem grešaka u sve tri verzije, koristi se veliki broj skraćenica koje ponekad deluju zbunjujuće, u neku ruku, u nekim segmentima Nacrt zakona nema pravnički stil pisanja i ako ovako prođe u ovoj verziji, biće veoma teško sprovodljiv.

Potrebna je znači jedna dublja analiza, čitanjem član po član i da kažemo stav po stav, jedino da se izvrši dobra preformulacija ili čišćenje od ovih grešaka koje su evidentne. U svakom slučaju, značajan zakon i mi ga u principu podržavamo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Hvala!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i u principu mi se slažemo i sa prethodnim govornicima i njihovim primedbama. Naravno, mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona, ali imamo neke primedbe koje bih sada izneo. Odnosi se na član 4. formulacije „klasifikacija poslovnih organizacija“. Po nama i naš stav je da bi to možda mogao mnogo bolje da bude u formulaciji „klasifikacija privrednih subjekata“ jer sadržina samog člana 4. baš govori o privrednim subjektima. Prethodni govornici su nešto spomenuli oko toga da baš ovaj član 4. ne zadovoljava potpunu formu samog člana.

Naše primedba se odnosi na kategorizaciju trgovačkih društva, pa velika trgovačka društva se spominju da je broj zaposlenih u jednoj finansijskoj godini od 50, naš stav je da je to relativno mala brojka. Po nama bi trebalo da iznosi više od 250 zaposlenih. Naravno, u stavu 1.1.1.godišnji promet, reč „promet“ bi moglo da se zameni rečju „prihod“ jer to nije isti slučaj. U članu, u stavu 1.1.2., takođe „bruto aseti imovina“, bolja formulacija bi bila „vrednost poslovne aktive“, i tako dalje i tako dalje. Ali, u svakom slučaju, mislim da ovaj nacrt zakona zadovoljava sve kriterijume i mi ćemo ga u načelu podržati.

Takođe, mislim da postoji jedna nejasnoća definicijom malih trgovačkih društva oko broja zaposlenih, gde se kaže recimo u stavu 1.3.3. prosečan broj zaposlenih u finansijskoj godini do 10, a onda zatim mikro preduzeća definiše broj zaposlenih, kaže u toku finansijske godine manji od 10, znači do 10 i od 10 manji od 10, opet može da dovede do nejasnoća prilikom implementacije ovog zakona u budućnosti.

Takođe ne postoje podaci o individualnom preduzetniku, koji je evidentni privredni subjekt u privredi i izjednačen sa ostalim trgovačkim društvima, odnosno ostalim privrednim subjektima, i možda još jedna konstatacija u članu 13. stav 6.2. citiram: “kada punomoćnom presudom...” i tako dalje, po našem mišljenju, „punomoćna reč“ ne bi mogla tu da bude prihvatljiva, već „pravosnažnom presudom“. U svakom slučaju, mi ćemo iskoristiti pravo da u radu parlamentarnih komisijama damo doprinos ka poboljšanju ovog teksta nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Hvala!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush

VEZIRA EMRUŠ: Hala lepa na datu reč!

Ja sam pažljivo slušala prethodne kolege. Meni je jako žao što moram da kažem, kada je u pitanju Zakon o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji, da je ovaj zakon jako loše urađen, da nema dobru definiciju, da nema glavnu definiciju kada je u pitanju vođenje računovodstva, gde se opisuje kao registracija u dnevnik i na račun svih akcija i ekonomskih činjenica koje pripadaju ekonomskoj jedinici.

Meni je maternji jezik srpski i u ovoj definiciji ja ne vidim ništa od računovodstva. Meni je jako žao, izvinjavam se svim kolegama da su olako prošli preko ovog zakona, jednog od najvažnijih zakona na ime koga, preko svih aktera i subjekata punimo kosovski budžet. Ako nismo napravili dobar zakon i ako ga nismo uskladili sa međunarodnim standardima, onda ništa nismo uradili za sledeću godinu.

Ja mogu da kažem da je Uredba UNMIK-a, ovde je spominjana od više kolega, broj 2001/30, da je ovaj zakon mnogo bolje analiziran u ovoj uredbi nego danas u ovom zakonu. Ovaj zakon je praktično preskakan, samo su neke definicije i da kažem članovi onih što su se sviđali, da ne kažem grupi ili radnoj i prepisivanih, ne znam kakva je ovo, kakav je zakon na albanskom i engleskom jeziku, ali na srpskom jeziku je katastrofa, katastrofa, kada je u pitanju prepis i više zahtevamo da kada je u pitanju barem da kažem legistratura, da se poštuju pojmovi da bi nama poslanicima bilo jasno. Ja sam sama kažem ekonomista i meni je žao što u ovom zakonu i hoću posebno da dam do znanja gospodinu ministru, da ovaj Zakon, prvo ne daje nijednom akteru, ima definicije kao vođenje računovodstva, sistem knjigovodstva, godišnji izveštaj, definiše revizorske firme, definiše računovođe, licenciranje, definiše centralnu banku, ali nema nadzor. Kao novo u ovom zakonu imamo ponovo da je predloženo formiranje kosovskog Saveta za finansijsko izveštavanje. Opet imamo dupliranje subjekata i nezavisnih organa u koje faktički zapošljavamo ljude, dupliramo organe po svim zakonima i pravimo samo teret budžetu umesto da štedimo.

Ovaj zakon nema osnovnu, osnovnu, molim kolege da me slušaju, osnovnu da kažem azbuku knjigovodstva. Knjigovodstvo kada je opisano mora da se vodi i u aktivni i u pasivi. Ovde su formulisani subjekti, knjigovodstveni subjekti koji su na terenu Kosova, samo na ime dobiti od – do, zarađuje 50, iznad 50, iznad..., ali nigde ovaj zakon ne obavezuje sa kojom investicijom stupa na tržište subjekat i to je aktiva sa kojom, to je jako važno za dolazak investitora, koje on bogatstvo donosi, koju aktivu da bi ostvario dobit i da bi zapošljavao i da bi imao elemente za dalje.

Meni je jako milo što ministar ovo prati i što vidim da ima jednu logiku, a posebno, posebno kada je u pitanju ovaj zakon, kada su u pitanju definicije subjekata, mora da se vodi računa i da se napravi registar svih preduzeća, ne samo preduzeća svih delatnosti, svih pomoćnih, svih hotelskih usluga, sve da se navede u ovom zakonu zato što su svi akteri koji moraju da daju finansijski izveštaj. Nisu obuhvaćeni svi subjekti, ostavljeno je tržište da bude i dalje sivo tržište. Ovo smo dozvolili u zakonu. Molim vas da naročito funkcionalne komisije, meni je žao što nisam u Komisiji za budžet i financije, naročito da funkcionalne komisije dobro pogledaju zakone iz regije, međunarodni zakon i da jednostavno naprave zakon koji će biti sprovedljiv i gde ćemo imati celokupan izveštaj i analizu aktive i pasive svih aktera u računovodstvu, svih aktera znači koji zarađuju, koji su na terenu Kosova.

Ovo je jako bitno zato što ovaj zakon meša pojmove i nema dobru strukturu kada su u pitanju, da kažem, zakonske odredbe i mora se oko ovoga, mora da se pazi. Meni je žao što moram da kažem kada su navedeni ovi stručnjaci koji su radili, Radna grupa Vlade, ja odavde ne poznajem nikog lično, nemam ništa protiv nikog, ali da se dobro zakoni rade sa ciljem, sa definicijom sa namenom, sa registracijom subjekata, sa obavezom koju obavezu imaju ti subjekti da bi imali pravu namenu i da bi nama bili zakoni, da kažem, razumljivi, nama kao poslanicima, a posele akterima koji to ispunjavaju.

Ova obaveza je postojala uvek, ovo nije novina za nas poslanike i za tržište Kosova, znamo da nije bilo poštovano punih 10. godina, i da moramo više ove aktere da prepoznamo jer to je jedini način. Mi svi znamo da najveći priliv dolazi od, da kažem, carine. Mi znamo ako idemo u zajedničko

tržište, biće bez carinske zone pojedinih proizvoda, više Kosovo neće moći zarađivati samo na ime carina, nego mora da poznaje subjekte i aktere u privredi, proizvodnji, delatnosti da bi punilo svoj budžet, da bi građani imali normalno bolji standard. Ja ovo kažem, u potpunom, u saglasnosti sa svojom grupom, gde smo razmatrali zakon, gde ćemo svoje doprinose da damo mi kao poslanici pojedinci i nadam se da će ovaj zakon kada bude prošao kroz funkcionalne komisije, biti dobro analiziran zato što je preko potreban kosovskom društvu i mi ga podržavamo kao zakon, ali u jednoj formi obrađenoj i dobro analiziranoj zato što će on biti sprovodljiv možda 10-15 godina, dobro znamo da moramo i dobro da ga uradimo. Hvala na pažnji!

Drejtmin e seancës e merr anëtarit të Kryesisë, Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupet parlamentare i kanë kryer diskutimet, tani sipas radhës janë deputetët që do ta marrin fjalën. Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Jo, ju faleminderit, zoti kryesues! Nëse bën, unë do ta marrë fjalën për Rregulloren...

KRYESUESI: Jo, jo për ligjin, e kemi kaluar.

EMRUSH XHEMAJLI: ... Për Rregulloren, unë e di që në çdo kohë ka mundësi të merret fjala, kështu e di Rregulloren. Nëse nuk është ashtu, unë kërkoj falje, unë kështu e di.

KRYESUESI: Jo, në çdo kohë është e përcaktuar kush mund dhe kur mundet. Tani në mes të pikës të rendit të ditës, ju e morët fjalën për ligjin, jeni paraqitur për ligjin...

EMRUSH XHEMAJLI... Kur mund ta marrë fjalën për Rregullore?

KRYESUESI: Për Rregulloren, në fillim të seancës.

EMRUSH XHEMAJLI:... Në fillim të seancës.

KRYESUESI:...Në qoftë se ti konstaton që të është bërë ndonjë e padrejtë, mund të flasësh.

EMRUSH XHEMAJLI:... Po, mua më është bërë një e padrejtë. Unë e kam kërkuar fjalën në fillim të seancës. Ti e di...

KRYESUESI: A po na lejon...?

EMRUSH XHEMAJLI... Ti e di që e kam kërkuar, emri është i regjistruar aty, nuk ma ke dhënë fjalën, kështu që ma merr mendja se është bërë shkelje e Rregullores edhe jo vetëm për mua, por është drejtuar mbledhja në mënyrën shumë të pasqyruar, sepse edhe ata që kanë grupe parlamentare, ju nuk ua dhatë fjalën me sa e pashë edhe kjo është një diçka që unë nuk e kuptoj. Kjo nuk është as në frymën e Rregullores, as në frymën e debatit, diskutimit demokratik me një Kuvend.

KRYESUESI: Ju faleminderit! E kreve?

Mendoj që nuk qëndron kjo që po thonit. Na jemi në parlament dhe i jemi nënshtruar Rregullores së Parlamentit dhe nuk jemi në Këshill të përgjithshëm të LPK-së, që mund ta merrni fjalën sa herë të doni, një. E dyta, unë e lexova pikën 42 të Rregullores dhe nuk ia mohova të drejtën askujt të flasë.

Mendoj që më mirë është tek pika e radhës kur të hyjmë të gjithë diskutojmë për pikën e radhës, rendi i ditës miratohet në Kryesi e jo në Parlament, dhe mocion nuk ka pasur dhe tani, tani ata kryetarët e grupeve parlamentare nuk po ankohen, ti po ankohesh.

Ok, u krye.

Fjalën e ka deputeti, Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Shumë gjëra u thanë këtu nga parafolësit, por megjithatë do t'i thosha disa gjëra edhe atë ndryshe nga ajo që i pata thënë herën e kaluar, vjet kur u bisedua, kur u debatua në realitet ky ligj në Parlament. Me të drejtë u thanë se shumë gjëra nuk janë marrë parasysh, por edhe shumë gjëra qenkan marrë parasysh.

Megjithatë, do të ndalem te disa, për dike mbase të imëta, por jo edhe për njerëzit e profesionit se ia vranë syrin, sidomos kam të bëj me terminologjinë dhe këtu e kam përpara unë këtë Ligjin për shoqëri tregtare, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze të Kosovës. Mendoj se te pika 1.8, te shoqëria e huaj tregtare, nuk kemi nevojë t'i themi Foreign Trade Business Organization por mund të jetë dhe duhet të jetë pa Trade, e jep kuptimin.

Unë nuk kisha për t' u pajtuar me atë që u tha këtu se nuk janë të qartësuara sipas ligjit, nëse përcillet ligji për shoqëri tregtare, shumë mirë i qartëson se kush është i obliguar që t'i bëjë pasqyrat financiare me kohë, është çështje tjetër që nuk respektohet në përputhshmëri.

(Reagim nga salla)

Jo, nuk do të ndalem te puna, se këtu u prek. Kam biseduar, në realitet kam debatuar herën e kaluar për nenin 12, për ato dokumente të cilat duhet të ruhen. Siç po shihen, nuk e kanë të qartë disa se dokumentet duhet të ruhen për një kohë aq më tepër në kompjuter, për një kohë edhe më të gjatë se 6 vjet, për shumë arsye. Keni parasysh po mos të ishin ato dokumentacione të ruajtura të Enron-it, skandalit që ndodhi, ku do të ishte ajo kompani. Andaj, në Kosovë për më tepër duke pasur parasysh se sa respektohet ligji, këto dokumentacione duhet të ruhen edhe për një kohë më të gjatë derisa ligji, domethënë derisa mundësisht apo teoretikisht ka mundësi që të kthehemi në retrospektivë dhe ato duhet të jenë mbi 10 vjet.

Kësaj radhe do të ndalem pak te kreu IV, mendoj se këtu diçka nuk është në rregull, te kualifikimet për kontabilistë. Pika 20, më falni neni 20, pika 3 thotë: kandidatëve për kontabilistë të certifikuar, kandidatëve në realitet, do t'u kërkohet të kenë tri vjet përvojë pune në lëmin e kontabilitetit që është në rregull, mund të jetë edhe më shumë, pastaj thuhet se duhet të kenë marrë diplomë universiteti dhe unë shtroj pyetjen – çfarë diplome, të cilit fakultet, duke marrë parasysh se personat në këtë rast kontistët apo po flasim për mbajtësit të librave, personat që edhe më tutje nuk janë bërë kontabilistë, kanë kaluar po them, i kanë kaluar provimet e certifikimit dhe trajnimet e ndryshme. Andaj, fakulteti po më duket është një kërkesë e tepruar këtu tash, nuk di pse, edhe nga fakti se kontabiliteti është zanat është dhe me standarde të veta.

Ne nuk kemi për aq sa di unë fakultet të kontabilitetit. Të gjithë ata që e kanë studiuar ekonominë, e dinë se nuk është e mjaftueshme apo nuk është primare në realitet studentët të cilët e kryejnë ekonominë dhe me një kontabilist të cilin ose i fusim në një vend, i testojmë me një kontabilist me shkollë të mesme, do ta shohim se ai, në realitet më falni, kontistin, a – mbajtësin e librave, do të shihet se mbajtësi i librave do të jetë shumë më i shkathhtë. Me fjalë tjera, mendoj se kjo kërkesë nuk

është obligative as në perëndim, me kusht që, gjithnjë po them, personi në fjalë i ka kaluar të gjitha trajnimet dhe testet të cilat parashihen sipas standardeve.

Për mos ta zgjatur më shumë, unë u kapa në këto gjërat esenciale, po them, për të mos u futur edhe në disa gjëra të imëta. Unë sinqerisht do të kërkoja nga Shoqata e Kontabilistëve që ta kenë parasysh cili fakultet të pasuron më shumë për këtë profesion, gjithnjë po them duke marrë parasysh përvojën e punës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Të nderuar ministra dhe

Deputetë të respektuar,

Do të kisha sugjeruar një nga metodat më të mira për përgatitjen e projektligjeve. Të merret një nga aktet ligjore që është në fuqi i një shteti dhe këtë repes akte ligjore të shteteve tjera edhe të krahasohet dhe të bëhet, se nuk është fjala për zbulim as nuk është fjala për bërjen për herën e parë në historinë e së drejtës të një akti ligjor. Edhe në atë mënyrë do të bënim ligje edhe të mira edhe të dobishme. Kjo është një parim edhe kësisoj do të evitoheshin shumë shmange nga kërkesat, nga premiset edhe postulatet themelore, metodologjike.

Duke e mbështetur këtë punë të Ministrisë edhe te ekipi që e kanë përgatitur këtë do t'i jap disa vërejtje parimore. Nuk duhet të përdoret asnjëherë në shumës, bie fjala shoqëritë tregtare, këta, këta, këta, sepse më të parën herë duhet në njëjës se, nëse e themi në shumës, atëherë del se në një entitet biznesor nuk ka kurrfarë të drejte as kurrfarë obligimi, sepse duhen së paku dy. Ky është parim që aplikohet në jurisprudencën bashkëkohore, prandaj kësisoj do të duhej të ishte gjithmonë edhe këtu edhe gjetiu. Kur po angazhohemi që të jenë shprehjet precize e koncize, e fleksibile, ndokush ndoshta që nuk merret vesh sa duhet dhe si të duhet, e sheh për të madhe. A nuk është kjo, kjo, kjo është substanciale për juridiken, për normativën se na e pamë ndër të tjera, Kushtetuta, ligji suprem i vendit që ka defekte edhe ato defekte sa kokë dhembje i shkaktojnë shtetit në përgjithësi. Prandaj shprehjet adekuate, adapte janë tepër primare për aktin ligjor, a në këtë rast, a në këtë rast bile do të kisha parafrazuar kolegen Vezira Emrush që i dha një varg vërejtjesh, të gjitha qëndrojnë, ka edhe më shumë sa i përket terminologjisë te tri gjuhët. Bie fjala, jo Banka Qendrore, ndër tjera “nënkupton”, por “është” është kjo edhe e kemi miratuar këtu, ose neni 5 në vend që thotë: “auditori”, thotë “auditivi”, tash auditivi e dimë që është një substancë kimike, i ka disa funksione krejt tjetër fare, e tjera, e tjera.

Ose te neni 1, ku thuhet ndër tjera: “Këshilli kosovar për raportim financiar”, nuk ekziston fare në dispozitat shpjeguese dhe del se kush është, kush qenka ky organ, por duhet të thuhet: “Ministria”, në këtë rast NEF-i, e tash në kuadrin e NEF-it mund të ketë edhe këshillë të tillë.

Te neni 21 edhe neni sidomos te neni 23, ju lutem, paragrafi dy ja se si shprehet: “në rast të konstatimit të shkeljes së këtij ligji, Komisioni për hetim dhe disiplinë mund të japë vërejtje personit”. Shikoni çfarë nonsensit, do të thotë, nëse e konstaton shkeljen e ligjit mund t'i japë fakultativisht, që i jep autorizim që edhe mos t'i jep kurrfarë vërejtje, tek e fundit edhe nëse i jep çfarë bëhet me atë punë? I jep vërejtje. Kur shkelet ligji, duhen të ndërmerren sanksione juridike e jo t'i jepet vërejtje edhe atë në fakultativen, mund t'i japë, domethënë sikur ta miratonim kësisoj, na do t'u jepnim autorizim autoriteteve publike që me të vërtetë haptas ta bëjnë shkeljen e ligjit ose bie fjala mund t'i japë vërejtje personit apo shoqatës tregtare. Shoqata tregtare, nuk ka shoqatë tregtare,

ka vetëm shoqëri, kompani, ju lutem shoqata është organizatë jo profitabile, bie fjala është Shoqatë e Juristëve, që është Shoqata e Juristëve të Kosovës, bie fjala ajo nuk është profitabile, e mora si shembull se kam qenë një kohë kryetar e tjera e tjera, por shoqëri, shoqëria do të thotë, janë dallime substanciale, ose te paragrafi i tretë, Komisioni thotë: vendos gjoba administrative në rastet vijuese. Komisioni vendos gjoba, domethënë, jo, po dënime me të holla, por nuk vendos, por cakton në procedurë.

Edhe disa, te i njëjti nën paragrafi 4, nëse një gjobë e shqiptuar, gjoba nuk shqiptohet, por caktohet, shqiptohet kur mësuesja në fillore i thotë: “kësoji duhet të thuash, kësioj thuaje”, por caktohet, ju lutem, kjo është edhe në gjuhët tjera. Nga Komisioni për hetim dhe disiplinë nuk është paguar KKKFRJ, do të iniciojë procedurë gjyqësore. Kjo do të ishte një procedurë me të vërtetë kontrare me qëllimin e ligjit. Po në qoftë se nuk e ka zbatuar dënimin me të holla, e inicion procedurën për inkasim të dhunshëm, nëse e ka marrë formën e prerë, se jo procedurë gjyqësore edhe aty çka do të ndodhte, nga 5 vjet të sigurt do t’i kishte për të pritur se ta ftonte gjykata në seancën e parë.

Te neni 5, te paragrafi 5, palët, te neni 23- Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit, mund të paraqesin ankesë në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit. Kujt? Domethënë këtu do të mbetej çështja e hapur që me të vërtetë nuk do të dinte as zbatuesi i ligjit, as pala në procedurë nuk do të dinte se kujt i adresohet me ankesë, duhet të precizohet se kush do të ishte instanca e dytë, adresa e plotë, sepse kjo është shumë e rëndësishme për procedurë.

Këto janë nga një varg i vërejtjeve të karakterit parimor. Natyrisht se do të bëjmë orvatje që edhe në procedurën e dytë të japim ndonjë kontribut modest në të mirë të kompletimit të këtij akti ligjor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, e fundit.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Mbase unë do të mbaj një qëndrim pak sa më ndryshe nga kolegët e mi deputetë dhe do të jem mbase më përkrahëse dhe ithtarë e këtij projektligji. Nëse duhet me e vlerësuar një projektligj që ka ardhur mjaft mirë i përgatitur dhe i trajtuar mirë për materien të cilën e ka përbrenda, është ky projektligj, do me thënë Projektligji për raportim financiar, për kontabilitet dhe për auditim.

Është ndër ligjet që vërtetë është për ata përshëndetur këtë grup punues që e ka trajtuar mjaft mirë dhe e ka paraparë të gjithë çështjen të cilën duhet ta ketë përbrenda materia e këtij projektligji, mbase një çështje që ka nevojë ndoshta të ndryshohet, është vetëm një emërtim që për mendimin tim do të kishte një efekt shumë të vogël apo një efekt shumë minimal karshi atyre që u potencuan në këtë Kuvend. Sido qoftë është terminologjia e përdorur: “shoqëri tregtare” që vërtetë ndoshta për organizimet e bizneseve, do të ketë terminologji më adekuate, por sidoqoftë e rëndësishme nuk është kjo karshi asaj që vërtetë trajtohet në nenin 9, sepse objekt i raportimit financiar nuk janë emërtimet, por janë tri elementet që vërtetë janë paraparë në këtë projektligji por se, si duket kanë shkuar pa u lexuar mjaft mirë nga debutuesit dhe aty është qarkullimi vjetor është janë asetet apo pasuritë dhe janë numri mesatar i të punësuarve, domethënë janë tri elemente kyçe që janë paraparë në këtë projektligj dhe vërtetë që ka nevojë të bazohen për ta parë se raportimi financiar ka qenë i drejtë, ka qenë në rregull apo nuk ka qenë në rregull.

Sa i përket licencimit të auditorëve, mjaft mirë e ka trajtuar dhe në një si duket sfera që më së shumti është e mbulua me ligje tjera që vërtetë i kanë gjobat më rigorozë, i kanë të trajtuara më

mirë çështjet, është ky projektligj. Prandaj, mendoj se duhet përkrahë si të tillë, sepse e ka ndoshta pjesën dërmuese të materies që duhet ta trajtoj dhe e ka paraparë mjaftë mirë dhe drejtë.

Ndoshta duhet paraparë te kreu tre, te përzgjedhja e anëtarëve të Bordit, sepse kjo përzgjedhje nuk është paraparë në mënyra specifike se si do të zgjidhen, kur kemi parasysh se kemi të bëjmë ë me institucionet që vijnë nga Banka Qendrore, nga Oda Ekonomike, janë tre anëtarë që do të vijën, do me thënë nuk është paraparë drejtë mënyra e përzgjedhjes së tyre, mbase kjo do të mund të rregullohet me një akt tjetër normativ, ligjor siç janë rregulloret apo aktet tjera.

Është edhe çështja e komisioneve që e ndihmojnë punën e këtij këshilli sepse Këshilli është ligjvënës dhe është, i përcjellë politikat e kontabilitetit dhe raportimit në Kosovë dhe ka komisione të veçanta mbasi janë 6 komisione që ka nevojë edhe kjo të trajtohet pak më mirë se si përzgjidhen ato komisione dhe mënyra, kush do të jenë ata që do t'i përzgjedhin këto komisione. Çështjet tjera janë mjaftë mirë të detajuara dhe të precizuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti ministër, a e dëshironi fjalën?

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Konsideroj që disa elemente që u ngritën këtu mbase duke u përpjekur për të lënë një pasqyrë profesionale për të mos nxitur debat nuk dua t'ia përmend emrin por elementet e shumta që u përmendën nga disa deputetë të nderuar poshtë janë të përfshira në standardet e kontabilitetit dhe nuk kemi nevojë të futim 2000 faqe faktikisht standarde të kontabilitetit në ligj. Në qoftë se një çështje, qoftë për ndërmarrjet e vogla atje, qoftë për çështjet e kualifikimeve të caktuara përcaktohen me standarde të kontabilitetit dhe thuhet që ky ligj të gjitha ato elemente i zgjedh në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, atëherë ato definitivisht sipas vetë si të them preambulës zgjidhen në bazë të atyre standardeve dhe ata që e njohin kontabilitetin dinë çfarë do të thonë ato. Prandaj, për hir të opinionit dhe për ju deputetë të nderuar që i dëgjuat disa vërejtje të tilla, dua të ju referohem se të gjitha këshillat janë që mos të bëhet ligji i stërmadh, përkatësisht mos të kopjojmë nga standardet e kontabilitetit dhe të fusim në ligj gjana të cilat ndërkombëtarisht janë të njohura, por ligji të ju referohet atyre pikave, atyre elementeve. U ngritën disa elemente sa i përket kualifikueshmërisë për të qenë kontabilistë më duket nga zoti Tali, ne gjatë Komisionit parlamentar do të ulemi e të shikojmë në mënyrë më të definuar apo me akte të tjera nënligjore për të përcaktuar se cili do të jetë titulli përkatës i një kontabilisti të certifikuar apo një auditori të certifikuar dhe do të bashkëbisedojmë po ashtu edhe me universitetet këtu se si të zgjidhim këtë dilemë.

Gjithsesi ju falënderoj, unë konsideroj që është bërë një hapë përpara dhe gjatë Komisionit parlamentar do të jemi bashkëpunëtorët tuaj për të tejkaluar çfarëdo dileme apo për të rritur kualitetin e këtij ligji. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Konstatoj se diskutimet janë ekzagjeruar rreth miratimit të projektligjit.
Tani përgatitemi për votim. Regjia votojmë tani:

Në sallë janë 72 deputetë.

Faleminderit! Konstatoj se me 65 vota “për”, 1 abstënim, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin prej 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta

Shpresoj se do të kurseheni nga diskutimet, që s'kanë diçka kontestuese për ligjin.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. Dhe, ftoj të mos bëjmë prezantim të dyfishtë, mendoj se prezantimin po e bën ministri dhe ne në qoftë se kemi vërejtje, bëjmë vërejtje.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në kuadër të prioritetëve për vitin 2010 ka përcaktuar edhe zhvillimin dhe ngritjen e një sistemi efikas të mbrojtjes së pronës industriale në Republikën e Kosovës.

Pronësia industriale është një nga fushat bazë bartëse të zhvillimit të ekonomisë, prandaj mbrojtja e saj do të thotë mbrojtja e investimeve, teknologjive të reja në procesin e prodhimit, ofrimi i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe novatore në treg. Kjo do të ndikojë në përmirësimin e strukturës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara në treg me qëllim të mbrojtjes së jetës, shëndetit të popullsisë, mjedisit, konsumatorëve, resurseve natyrore dhe rritjes së cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Në kuadër të ngritjes së këtij sistemi hyn edhe rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit në sferën e mbrojtjes së pronës industriale, me qëllim të harmonizimit të tij me standardet më të larta të BE-së në sferën e pronës intelektuale.

Projektligji për patenta është projektligji i tretë në këtë fushë që gjatë këtij viti Qeveria e ka proceduar në Kuvend, pas Projektligjit për markat tregtare dhe Projektligjit për dizajnin industrial.

Me projektligjin e ri është thjeshtësuar procedura e regjistrimit të patentave që paraqet një lehtësi për bizneset, sepse është hequr nga procedurat e regjistrimit në zyrën për pronësi industriale ekzaminimi substancial.

Janë rregulluar me dispozita përkatëse licencat e detyrueshme, e të cilat janë në harmoni të plotë me kriteret ndërkombëtare të kësaj sfere dhe me këto dispozita është përcaktuar edhe organi kompetent për dhënien e licencës së detyrueshme në rastet kur mund të jepet një licencë e tillë.

Janë vendosur dispozitat të cilat kanë të bëjnë me shpikjen sekrete dhe procedurat e regjistrimit të këtyre shpikjeve.

Janë specifikuar qartë dispozitat që kanë të bëjnë me aplikimet në pronarë të jashtëm të të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i patentave në zyrën për pronësi industriale.

Janë përfshirë dispozitat lidhur me kushtet e qarta që kanë të bëjnë me përfaqësimin e të huajve në procedurat para Zyrës së pronësisë industriale.

Janë paraparë dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin ndërkombëtar të patentave të cilat do të hyjnë në fuqi nga dita e regjistrimit të Republikës së Kosovës në Konventën Evropiane të Patentave.

Janë përmirësuar dispozitat për patenta dhe aplikimet e tyre si objekte të pronës industriale që kanë të bëjnë me të drejtën e transferimit, licencimit, patenta si objekt i pengut, konfiskimit dhe falimentimit.

Gjithashtu, Projektligji përmban dispozita të reja sa i përket zbatimit të të drejtave të patentës dhe procedurat civile-juridike për mbrojtjen e të drejtave të patentës, e të cilat janë në përputhje të plotë me direktivën e zbatimit në BE që përbën ndryshim pozitiv nga ligji aktual.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji do të harmonizojmë plotësisht ligjet nga sfera e patentave me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe hapet rruga për implementimin e dispozitave të tyre, gjë që do të ndikojë në qasjen më të lehtë për mbrojtjen e pronës industriale në Kosovë dhe nuk do të paraqiten pengesa në zbatimin e obligimeve dhe të drejtave gjatë procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare të sferës së pronës intelektuale.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e pronës industriale, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani hap debatin për diskutim. Sipas Rregullores, fjalën e ka raportuesja e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se projektligji ka ardhur një kohë pak më herët në komisionin parlamentar dhe mund të them se komisioni parlamentar në parim e përkrah Projektligjin për patenta me një vërejtje, ministër, nëse na kuptoni, në mënyrën më të mirë, që Projektligjit t'i ndërrohet titulli – Ligji për patentim.

Duke e ditur se e kemi një ligj për patenta, i cili në këtë periudhë duhet të ketë plotësim-ndryshime, atëherë kemi kërkuar edhe nga komisioni që t'i ndërrohet së paku kjo fjali në ligj.

Komisioni parlamentar e ka përkrahur Projektligjin për patenta dhe, shpresoj, pas këtij leximi do të kryejë procedurat për të cilat është i obliguar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përschendetje, ministra të pranishëm!

Të nderuar kolegë deputetë dhe gjithë ju tjerët që jeni prezentë në këtë seancë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj. Duke qenë se ky projektligj është në Strategjinë legjislativë të vitit 2010 dhe duke pasur parasysh qëllimin, përkushtimin dhe angazhimin e Qeverisë së Kosovës që të përafrojnë legjislacionin vendor me legjislacionin e aplikueshëm të përshtatur të BE-së, e mbështesim në parim.

Edhe pse projektligji në fjalën e përcjellin lëshime të natyrës teknike, e përcjellin gabime të shumta gjuhësore, si dhe lëshime logjike, duke krijuar kështu konfuzion në dispozita, respektivisht në mesnive të këtij ligji.

Ne e dimë se aktualisht është në fuqi Ligji Numër 2004/49 për patentim, i cili është në sferën e mbrojtjes së pronësisë industriale, që në këtë sferë hyjnë edhe ligje të tjera, siç është Ligji për dizajnin industrial, Ligji për markat tregtare, të cilin ligj e ka në procedurë Komisioni për Ekonomi, Tregti dhe Industri, si dhe Ligji për topografinë e qarqeve të integruara. Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është... funksionon do me thënë zyra e cila merret ekskluzivisht me zbatimin e këtyre ligjeve që i përmendëm. Si Grup parlamentar, e mbështesim në parim, po e përsëris edhe një herë. Dhe dilema jonë është se duke parë dinamikën e punës së komisionit parlamentar, i cili është përgjegjës për amendamentimin e këtij ligji dhe i cili komision është i ngarkuar edhe me ligje tjera, dyshojmë se do të arrijmë ta përfundojmë në kohën e duhur, siç është e paraparë me Rregulloren e punës së Kuvendit brenda dy muaj ditëve pas leximit të parë.

Sidoqoftë, ne si Grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta japim kontributin maksimal në komisionin funksional, në mënyrë që të përshpejtohet edhe procedimi i tij në afatin e paraparë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit!

Përschendetje për të gjithë të pranishmit!

Unë do të falënderoj për një ligjëratë të mirë në komision dhe kontributin që e ka dhënë Ethem Çeku dhe na e ka lehtësuar për ta përkrahur në parim këtë projektligj. Kështu që e kam pasur lehtë ta bind grupin parlamentar, prandaj plotësisht është...

Pra, qëllimi i këtij projektligji ka pasur kryesisht temën që u tha këtu edhe nga ministri, pra harmonizimin dhe unifikimin e këtij projektligji me aktet ligjore të Bashkësisë Evropiane, kështu që tri çështjet të cilat janë adresuar më mirë dhe që bien në sy nëpër kapitujt e këtij projektligji janë, e para, mbrojtja e pronësisë industriale, patentat dhe të gjitha detyrimet që dalin për të respektuar standardet dhe çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Te pjesa po ashtu që ka të bëjë me adresimin e saktë, institucioni që është ngritur brenda dhe në kuadër të këtij projektligji, pra tek Ministria është Zyra për pronësi industriale, kompetencat pastaj të gjitha kriteret e licencimit, zbatimit, qoftë të rregulloreve, qoftë të marrëveshjeve të cilat i detyrohen... po ky projektligj kur ka të bëjë pra edhe me Organizatën evropiane të patentimit dhe e veçanta është ajo që ky projektligj do të japë një kontribut tjetër të madh në sferën e ekonomisë së vendit në mënyrë të veçantë, pra për pronarët që kanë patentat, për produktet industriale apo ato intelektuale, të drejtat ekskluzive të tyre që kanë të bëjnë me prodhimin, me tregtimin, me bartjen e kësaj licence, por edhe

me gjithë ndërmarrjet në vendin tonë që kanë të bëjnë me eksportin apo importin e prodhimeve të cilat drejtpërdrejt do të ndikojnë pra në një konkurrencë, do të ndikojnë në treg, do të ndikojnë në cilësi dhe do ta rrisin pra dukshëm këtë, në krahasim me rrethanat aktuale. Prandaj, në parim ne e përkrahim dhe mendoj se me këto rregulla do të mbrohen patentat dhe shumë ky ligj ose projektligj do t'i ndihmojë pra konkurrencës dhe ekonomisë së vendit, gjegjësisht tregtisë që të jetë me një cilësi me produktet dhe me moslejimin e modifikimit, e kopjimit dhe shumë gjërave tjera të cilat do të ishte që me mbikëqyrje të plotë të tij do të pengoheshin dhe nuk do të lejoheshin pra në ekonominë e vendit. Prandaj, ne e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu siç e tha edhe Fatmiri për projektligj, në komisionin tonë edhe si Grup parlamentar e mbështesim në parim këtë projektligj. Mendojmë që sfera që ka të bëjë me ekonominë nga Parlamenti duhet të ketë një veprim shumë më të fuqishëm që të plotësohet infrastruktura ligjore sa iu përket ligjeve që mbulojnë dhe rregullojnë fushën e ekonomisë në Kosovë, duke pasur parasysh se një nga problemet më të theksuara tek ne është niveli i ulët i zhvillimit, konkurrenca jo lojale, ekonomia e zezë apo ekonomia jo formale, pastaj mohimi i shumë veprimtarive të cilat do të kishin sjellë produkt apo sjell një zhvillim më të mirë në Kosovë.

Ky projektligj i cili sot është në lexim tek ne, mendoj se i rregullon disa nga problemet e theksuara të cilat kanë qenë në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit tek ne.

Një problem i theksuar është që ky projektligj mbas leximeve të mund të vijë sa më shpejt tek implementimi dhe realizimi i tij. E shohim se Ministria po ndërton mekanizma të saj për ta implementuar këtë infrastrukturë ligjore, mirëpo shohim se vazhdimisht kemi disa nga departamentet, institucionet e pavarura në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, do të thotë problemi më i madh është edhe te kostoja, edhe pse ky nuk ka ndonjë kosto të madhe buxhetore, mirëpo them edhe një herë se është e rëndësishme që ne si Parlament dhe si ekzekutiv të bëhet përpjekje për implementimin e ligjeve të cilat Parlamenti i Kosovës është duke i aprovuar. Nga disa projektligje apo disa nga ligjet të cilat jemi duke i mbikëqyrur, shohim se ka një mangësi të madhe në implementimin e ligjeve.

Në parim, Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin tonë parlamentar.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, kush e do fjalën? Deputetja Selmani, e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëendetje për të gjithë!

Duke marrë parasysh se Projektligji për patentat është në grupin e projektligjeve të cilat mundësojnë investime më të lehta në Kosovë dhe përmirësim edhe të investitorit edhe të importuesit dhe eksportuesit në përgjithësi dhe duke marrë rëndësinë që ky projektligj duhet të harmonizohet me direktivat e BE-së së bashku me projektligjet të cilat i përmenda pak më parë, jep mundësinë që Kosova edhe pse nuk është në Organizatën Botërore të Tregtisë të japë mundësi që pas implementimit të këtij ligji për patentat të jetë një mundësi më e mirë për Kosovën dhe të përafrohemi me legjislacionin e BE-së që Kosova të jetë e përgatitur për hyrje në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në parim, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah Projektligjin për patentë, vetëm me një vërejtje në rast se ministri është i pajtimtë dhe të gjithë deputetët të cilët do t'i japin sugjerimet e tyre që titulli të plotësohet pak më ndryshe dhe njëkohësisht ishte edhe fjala e zonjës Berisha, e cila thotë se jemi të ngarkuar shumë me projektligje brenda komisionit, do të mundohemi që të mbërrijmë së paku këto projektligje të cilat i ndihmojnë zhvillimit ekonomik të vendit dhe mundësojnë hyrje në buxhetin e Kosovës, se ky projektligj sjell edhe të ardhura gjatë licencimit në pronën industriale dhe në çështjen e licencave të mundohemi që të amendamentojmë në kohën e duhur që të jenë të zbatueshme, ministër, pas nënshkrimit nga presidenti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Morina e ka fjalën!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë Projektligjin për patentë e konsideron tejet të avancuar dhe shpreh dyshimin për zbatueshmërinë e tij efektive në të ardhmen. Aktualisht ekziston Ligji për patentë, i miratuar në vitin 2004, për të cilin nuk kemi të dhëna se sa ka qenë i zbatueshëm dhe cilat kanë qenë vështirësitë e identifikuar për moszbatimin e tij, kështu që hartimi i një projektligji, sikurse qëndron në memorandum shpjegues, është iniciuar në bazë të Raportit të progresit të Komisionit Evropian, që ka kërkuar harmonizimin e mëtejme të infrastrukturës ligjore me atë të BE-së.

Zoti ministër, ekziston paqartësi se a është ky projektligj i ri, sikur na prezantohet nga ministria përkatëse e juaj, apo projektligj për ndryshimin e Ligjit për patentë sikur se prezantohet në memorandum shpjegues. Edhe pse me këtë projektligj do të duhej të lehtësoheshin procedurat e regjistrimit dhe të mbrojtjes së patentave, si dhe procedurat për mbrojtjen e të drejtave të patenteve, ne kemi disa vërejtje dhe dilema lidhur me këtë projektligj që do të duhej sqaruar.

Se ky projektligj është tejet i avancuar për vendin tonë, është nga se në nenin 10, që ka të bëjë me shpikje të patentueshme për trupin e njeriut dhe pjesët përbërëse të tij që kanë të bëjnë deri në nivel të gjeneve. Do ta citoj paragrafin 2, ju lutem! “Elementi i izoluar nga trupi njeriut ose që është prodhuar ndryshe me anë të procesit teknik, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, mund të përbëjë shpikje të patentueshme edhe pse struktura e tij e elementit është identike me atë elementin natyror”. Kjo sigurisht do të duhej sqaruar, zoti ministër.

Pastaj, te shpikjet sekrete, neni 15. Autoriteti kompetent për shpikje sekrete, parashihet të jetë Këshilli i Sigurisë në Kosovë, që më pas, në të njëjtin paragraf propozohet të quhet në tërë tekstin e Projektligjit – autoriteti kompetent, që konsiderojmë se është e pa arsyeshme nga se konsiderojmë se minimizohet rëndësia që do të duhej ta kishte ky këshill.

Gjithashtu, shumë dispozita të këtij projektligji janë të paqarta dhe kontradiktore. Si për shembull, neni 9, parasheh rastet kur kemi përjashtim nga patentshmëria, siç është metoda për trajtimin e trupit të njeriut me anë të kirurgjisë ose terapisë apo metodave diagnostifikuese të ushtruara në trupin e njeriut, siç parasheh neni 9, paragrafi 1.3. Kurse në nenin 11, paragrafi 4, nuk përjashton patentshmërinë që i referohet mu neni që parasheh përjashtimin e patentshmërisë.

Dyshimet tona bien edhe në kapacitetet e kësaj ministrie për të zbatuar këtë projektligj kaq të avancuar, sidomos kur e dimë që vlerësimet për implikimet buxhetore parashihet kostoja shtesë buxhetore vetëm prej 13.000 eurove për pagat e 3 punonjësve të ri. Kjo shkon në favor të mungesës së seriozitetit për zbatimin e këtij projektligji në të ardhmen.

Sidoqoftë, Lidhja Demokratike e Dardanisë do ta mbështet në parim këtë projektligj dhe do të kontribuojë në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Evo i moj pozdrav prisutnim ministrima, kolegama! Mi smo kao parlamentarna grupa “7+” takođe analizirali Zakon o patentu, tako da možemo se pridružiti našom analizom oko toga da recimo ovaj zakon, naša je jedna od primedba, dosta pati od onoga što kažemo pravnički stil, odnosno nema pravnički stil, ili se radi o prevodu koji je sa nekog od sličnih jezika, ili se radi o bukvalnim prevodima, tako da ima dosta izraza kojima mogu potkrepiti ovo o čemu govorim. Naime, recimo pominje se izraz “otkrivač” a radi se o “izumjeću” ili “pronalazaču”. To su uobičajeni reči o kojima se govori. Ima na neki način, nastoji da reguliše ovu materiju, dosta to može uspešno da ulini, ali je prisutan veliki broj grešaka, ne samo gramatičkih, nego koje menjaju i suštinu zakona. Za to kažem da treba u nastavku procedure izrade ovog zakona da mu se pristupi još malo ozbiljnije kako bi se ovi propusti na neki način uklonili. Recimo brkaju se pojmovi – “izum” i “patent”. Izum je delo, originalno delo nekog pojedinca, a patent se nekome može osporiti, jer može biti plagijat. Evo, samo jedan primer da navedem, međutim mi kao i ostale kolege, u principu prihvatamo u prvom ovom čitanju ovaj zakon da usvojimo, ali treba zaista poraditi na njemu da bi smo imali dobar zakon kako to zahteva naše društvo, odnosno država. Mi ga, znači, podržavamo i hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALILJI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Uvaženi svi,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i po našem mišljenju ovaj nacrt zakona zaslužuje našu podršku u načelu. Slažemo se sa prethodnim govornicima, vezanim za slovne i jezičke greške, kao i na stil pisanja i u tom smislu jedna od nejasnoća je i u članu 34. gde u prvoj rečenici stoji reč „zaplakacija“ pa je naše mišljenje da bi trebalo da ta reč pojasni. Takođe, imamo jednu primedbu vezano suštinski, znači za član 100, pod naslovom „Smrt ili pravna nemogućnost nosioca prava“, smatramo da bi trebalo da se odredi vremenski period korišćenja prava na patent naslednika ili pravnog naslednika posle smrti vlasnika patenta. To je jedno rešenje koje bi recimo mnogo razjasnilo ovu situaciju. Smatramo da možda bi jedan od predloga bio da se recimo od smrti vlasnika patenta, 50 godina ima mogućnost naslednik da koristi ovo pravo ili pravni naslednik, kako je u članu 100 formulisano.

Ponavljjam da ćemo mi svoj doprinos dati u radu parlamentarnih komisija i takođe da podržavamo u načelu ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Posle svih ovih kolega koje sam slušala, gde su imali dobre primedbe na ime Zakona za patente, koji danas imamo pred sedom, mi kao poslanička grupa pažljivo smo razmatrali ovaj zakon i ponovo moram da kažem da imamo, da kažem, svoje mišljenje da je jednostavno prevod jako, jako loš, nema stranu logike, kada su u pitanju pojedini članovi i opisivanje tih članova i njihova namena.

Ja çu da proçitam çlan 14, kada kaçe: “spvodnost u andustriji”. Pa kaçe: “otkriçe je spvodljivo u industriji ako njen predmet moçe da se proizvede u svaku vrstu industrije, ukljuçujuçi i poljoprivredu”. Prvo, spvodljivost u industriji, moçe biti patent, patent je spvodljiv u industriji ako njegov predmet moçe da se proizvodi u svakoj vrsti industrije, ukljuçujuçi i poljoprivredu, tako da sam ja malo pre kada je bio predašnji zakon na dnevnom redu, imala svoju primedbu i primedbu u ime grupe, zato što nam je teško da razumemo zakon, zato što su zakoni faktiçi loše prepisani i znamo svi da se to dešava bez analize jezičke, da potenciramo da se ovome u budućnosti malo više posveti pažnja. Mi smo do sada tolerisali kada je u pitanju jezička struktura zakona.

Jedno što je jako bitno, ja sam malo pre u svom izveštaju imala jedno pitanje od kolege koji je moj maternji jetik. Moj maternji jezik je goranski, školovala sam se na srpskom jeziku, zakoni se pišu na srpskom i ne verujem da će neko da ima razumevanje ovde i zbog mene da piše zakon na goranskom jeziku. Toliko. Hvala od mene!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Auditor i nderuar,

Angazhohem që së paku tash e tutje, meqenëse kjo punë nuk u bë asnjëherë deri më sot, që me dispozitat hyrëse ose në pjesën shpjeguese të jepet adresa se në të cilën gjuhë është hartuar ky dokument ligjor, që së paku ta lexojmë në atë gjuhë e jo në gjuhën e përkthyer, sepse përkthimet janë jashtëzakonisht të dobëta, aq më parë kur edhe teksti në origjinal, nëse mund ta quajmë, është i dobët, atëherë mund të imagjinohet se çfarë del në tekstin e përkthyer dhe së paku tash e tutje bile në cilin tekst, në cilën gjuhë është hartuar, sidokudo ajo është më autentike dhe më e kuptueshme.

Do të duhej që të plotësohej objekti i këtij ligji, sepse në doktrinë flas kësisoj, doktrinën kompetente, parimet dhe formulat nuk mbrohen. Ju lutem, nuk mbrohen ato si pronë, se këtu është fjala për pronat intelektuale, nuk ka pronë industriale. Ai është konstruksion, kështu pragmatik. Nuk ka prona industriale, atë e përdorin disa, por e përdorin ata/ato që nuk janë kompetent për këtë materie – prona intelektuale.

Dhe, athua ne a do të duhej të veshim një varg këso aktesh ligjore për të gjitha format e pronave intelektuale, se ka shumë forma të pronave intelektuale. Po e zëmë, ju lutem, patenta, licenca - Knowhow, po e zëmë, më pastaj sekreti tregtar, shenja tregtare, sekreti zyrtar e tjera. Ka forma edhe të tjera, prandaj do të duhej ta bënim vetëm një akt ligjor për pronat intelektuale, sepse të gjitha dispozitat tjera, aty janë shumica që i referohen cilëndo formë të pronës intelektuale, janë adapte për të gjitha pronat intelektuale. Specifike mund të jetë, si të them, karakteri e natyra e pronës intelektuale. Prandaj, duhet ta bënim një ligj e më pastaj ministritë respektive do të kishin pasur vend që me akte nënligjore t’i bënin plotësimet e tyre.

Te neni 51 dhe 52, medoemos duhet të bëhet një riformulim, një modifikim, novelim në funksion të definimit të qartë të ashtuquajturës kohë astronomike, se te regjistrimi i patentit është shumë me rëndësi kush e regjistron i pari, se mund të ndodhë, ka ndodhur edhe në praktikë, prandaj mund të ndodhë edhe te ne që të investohet, po e zëmë, 1 milionë euro për zbulimin, për shpikjen e një risie. Dhe tash aty investohet punë e madhe intelektuale, financiare dhe mund e tjera. E kujt do t’i pranohej? Do t’i pranohej atij apo asaj që do ta regjistronte i pari/e para. E kush? Atëherë aty hyn jo kjo, kush e regjistron i pari, se nuk është minuta, mund të ndodhë që në të njëjtin minutë të dy shpikësit ta prezantojnë regjistrimin – pranimin e patentit e më pastaj, kujt... Prandaj, aplikohet kudo në botën kontenporare koha astronomike, e kjo duhet medoemos të inkludohet në këto dispozita.

Po e zëmë, te neni 124. Ju lutem, shihni çfarë shpjegimi jepet. “Gjykata kompetente është gjykata kompetente”. Përnjëmend kështu ridiculous. Ju lutem! Duhet të merret... Hartuesi është dashur ta marrin... e kemi një ligj, një projekt a diçka – Ligjin për gjykatat dhe të shikohet fare mirë se cila gjykatë do të ishte, e në këtë rast, do të thotë do të mund të ishin dilemat, athua gjykata ekonomike, disa e quajnë gjykatë tregtare në botën e jashtme, e këtu quhet edhe komerciale ndonjëherë në anglisht, apo gjykata e kompetencës së përgjithshme. Gjithsesi do të duhej të përcaktohej – e cila gjykatë në konformitet me aktin ligjor special, në këtë rast, për gjykatat, se në atë mënyrë do të evitoheshin dilemat e mundshme që pashmangshëm do të paraqiteshin në praktikë. Dhe ato do të shkonin në disfavor të palës, e ligji gjithmonë miratohet në favorin e palës, jo të institucionit.

Dhe, përfundimisht, masat ndëshkimore. Do të duhej të përcaktoheshin jo ad-hoc, por t’i përshtateshin, e ka vende për më së paku 100 raste se kudo që thuhet “duhet” atëherë duhet “edhe masat ndëshkimore”, sepse aty është imperativi, prandaj për atë duhet, në dispozitën kur thuhet “duhet”, do të duhej që të përcaktohej edhe masa, u mor vesh me amplitudë prej - deri, apo jo, por jo gjëja por dënime në të holla dhe kush do t’i caktonte ato. Kush? I cili organ? Mos të ndodhë që më pastaj mos të aplikohet, se nuk dihet se kush, ose një organ që konsideron se është kompetent, del dikush e ia konteston, se nuk është dhe do të hapej një procedurë kontestimore e pambarim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutues të tjerë, nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë, dëshiron ta marrë fjalën? Jo. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të projektligjit.

Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Ju lus, kam diskrepancë në numrin e deputetëve që më janë dhënë dhe atyre që kanë votuar. Ju lus, për numërim fizik, edhe një herë.

I kemi 72 deputetë. Kanë votuar 76. Të shohim, mos është bërë gabim në numërim.

Unë e shpall votimin të pavlefshëm. Kërkoj që të bëhet rivotimi. Janë prapë 72 deputetë dhe janë 76 vota. Lus regjinë që të përsërisim votim. Dhe, ju lus, nëse dikush është habitur me kartelën e kolegut, i hiqni, s’ka nevojë të votohet se ka kuorum mjaft. Regjia, bëhuni gati për votim! Votojmë tash:

Tani është mirë. 72 janë “për”, 1 është “kundër”. Konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për patentat, ose për patentim, se mendoj që ishte e drejtë vërejtja.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, Telekomunikacion, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin prej 2 muaj, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime.

Mendoj se tash duhet ta bëjmë një pauzë, deri në orën 14:45 ose në 15:00. Atëherë, deri në orën 15:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin Policor

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, Shkumbin Demaliaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni funksional e ka pasur projektligjin në leximin e dytë. Është punuar intensivisht.

Kemi pasur një pengesë se Qeveria nuk ka sjellë në pako edhe Ligjin për pajisjen me armë e municion dhe pajisjet tjera të veçanta për organe të sigurisë, duke përfshirë këtu Forcën e Sigurisë së Kosovës, me një bashkëpunim falënderues dhe mirënjohës nga ICITAP-i, EULEX-i, OSBE-a dhe mekanizmat tjerë mbështetës të komisionit, në këtë rast, kemi arritur që të sjellim para Kuvendit dhe deputetëve amendamentet dhe rekomandimet e komisionit, të cilat edhe si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrahim dhe i ftojmë të gjithë deputetët e Kuvendit në votim të amendamenteve. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në Projektligj janë propozuar gjithsej 28 amendamente. Më falni, Gani Koci e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni! Zoti Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për hir të procedurave dhe në emër të komisionit duhet të theksoj se Komisioni për Buxhet e Financa nuk ka pasur kohë të shqyrtojë rekomandimet dhe amendamentet rreth implikimeve buxhetore të komisionit funksional, për arsye se të dielën, të hënën e të martën ka qenë i angazhuar pas një konference ndërkombëtare dhe dje nuk është punuar fare, kështu që si Komision ne s'kemi mund të mblidhemi që të shqyrtojmë implikimet eventuale buxhetore të amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional. Ne në parim e kemi miratuar atëherë dhe kemi konstatuar edhe koston financiare të këtij projektligji, që është miratuar. Tash nuk di, në aspektin procedural a mund të fillojmë votimin e amendamenteve pa një rekomandim të komisionit rreth implikimeve eventuale buxhetore në amendamente. Po shpresoj se amendamentet nuk kanë implikime buxhetore. Këtë e shtrova vetëm që në kuptimin procedural të jemi në rregull si Kuvend këtu dhe, natyrisht, edhe si komision.

Arsyeja pse s'kemi mund ta shqyrtojmë është se rekomandimet kanë qenë më vonë dhe komisioni ka qenë i zënë pas agjendës së vet, që e ka pasur, ju e dini si Kryesi dhe si kryesues i Kuvendit tani.

Nëse duhet, unë i kisha lutur ndoshta anëtarët e komisionit që në një 10 minutësh, 15 minutësh për të përmbushur anën formale, të takohemi dhe të dalim me një rekomandim. Po krejt theksi i kësaj është ajo që ne të jemi mirë me procedura të miratimit të ligjit e të mos kontestohet më vonë, pastaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaliaj, sipas komisionit tuaj, amendamentet që i kemi e do t'i miratojmë kanë implikime buxhetore...

SHKUMBIN DEMALIAJ: Duke qenë njëherazi edhe anëtar i Komisionit për Buxhet e Financa, gjatë shqyrtimit të parë kur është konstatuar nga vetë përfaqësuesi i Komisionit për Buxhet, është deklaruar dhe i dimë sa është ndikimi në këtë rast në buxhetin e Kosovës, mirëpo nuk ka ndonjë implikim, për shkak se vetëm teknikisht është rregulluar çështja rreth hetimeve disiplinore dhe rreth hetimeve, do të thotë, penale në këtë rast, duke përfshirë këtu edhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë. Nuk ka ndonjë ndikim buxhetor në këtë rast, kostoja është e njëjtë dhe shpresoj se nuk është e nevojshme të takohet komisioni dhe në këtë rast do të fillojmë me votimin e amendamenteve.

KRYSUESI: Zoti Mustafa e ka kërkuar fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: Zoti kryesues,
Desha ta marr fjalën për të sqaruar, sepse amendamentet e paraqitura nuk kanë implikime buxhetore. Ato janë plotësim i ligjit dhe jemi konsultuar edhe me ekspertë të ndryshëm dhe me anëtarë të komisionit dhe nuk ka nevojë për pritje. Unë kisha për t'i falënderuar të gjithë ata që kanë punuar në këtë ligj, edhe organizatat tjera të interesit që kanë ndihmuar, dhe kjo ka treguar edhe një herë që mund të punohet me dinamikë të shtuar kur ajo kërkohet. Unë kërkoj që të miratohen të gjitha amendamentet për Ligjin për Inspektoratin Policor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Koci, edhe një herë!

GANI KOCI: Unë po shpresoj që nuk ka implikime buxhetore, sepse këta kanë punuar dhe këta e dinë nga ajo baza fillestare dhe unë konsideroj që nuk do të jetë problem sepse në njëfarë mënyre edhe ky është konfirmim edhe i komisionit, sepse jemi të gjithë anëtarë të komisionit këtu që thamë edhe në emër të komisionit që të fillohet me miratimin e këtyre amendamenteve dhe të procedohet më tutje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Vujović, e ka fjalën!

RADMILA VUJOVIĆ: Hvala, uvaženi predsedavajući!

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Ja se izvinjavam što se javljam. Nije ništa strašno, nema grešaka, osim gramatičkih kada je u pitanju prevod na srpskom... Ja sam i sa gospodinom Nuredinom pravila neka poređenja. Verzija na albanskom i na engleskom je OK. Na srpskom ima grešaka, pa vas molim, da ne bi vas sad zadržavala da u pismenoj formi dostavim Komisiji, da se to ispravi. To je od prilike za 3-4 člana. Greške su koje menjaju i smisao i značenje članova.

Ako prihvata da u pismenoj formi dostavim, u redu. Ako ne, mogu da pročitam?

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj se do t'i marrim parasysht. Në bazë të diskutimeve të drejtuesve të dy komisioneve dhe raportuesit të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, zotit Demaliaj, zotit Koci dhe zotit Mustafa, konstatoj se nuk ka nevojë komisioni... Do të thotë, nuk ka implikime buxhetore, sipas tyre, prandaj edhe po vazhdojmë me votimin e amendamenteve një nga një.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 28 amendamente nga komisioni funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raport.

Në sallë janë 85 deputetë.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:
Miratohet! Faleminderit!

Amendamenti 2.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28, i fundit.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 28.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Ju njoftoj se në sallë janë 93 deputetë.

Votojmë tani:

Konstatoj që me 81 vota “për”, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, që është:

7. Shqyrtimi i rekomandimit për Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës

Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e ka shqyrtuar Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë për privatizimin e PTK-së me sqarimet shtesë të Qeverisë dhe Kuvendit i ka paraqitur 7 rekomandime për plotësimin e Strategjisë së Qeverisë për privatizimin e PTK-së, për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Ftoj në fillim kryeministrin ose përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë Strategjinë për privatizimin e PTK-së.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit shumë, i nderuari kryesues, Haliti!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Pas miratimit në parim të Strategjisë për privatizimin e Postës dhe të Telekomit të Kosovës, Qeveria e Kosovës, përmes komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së ka adresuar të gjitha komentet dhe sugjerimet tuaja dhe në këtë formë kemi siguruar transparencën më të lartë të mundshme për këtë projekt shumë të rëndësishëm për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ne po zhvillojmë shtetin e Kosovës sipas modeleve më të mira të botës së lirë. Kapitali privat do të përbëjë bazën kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Në Kosovë ka kaluar koha e ekonomisë centraliste e të planifikuar. Kosova është e hapur dhe do të vazhdojë të jetë e tillë për kapitalin privat, për konkurrencën dhe ekonominë e lirë të tregut.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një ambient shumë të sigurt për investime, si dhe ka garantuar një ekonomi konkurrense dhe të lirë, tanimë me model edhe për rajonin.

Privatizimi i PTK-së është reformë ekonomike dhe jo shitje e kapitalit. Ky privatizim është pjesë e reformave strukturale të dakorduara me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të cilat reforma i mundësojnë shtetit të Kosovës rritje ekonomike, stabilitet financiar si dhe ndihmë direkte buxhetore nga donatorët. Për privatizimin e PTK-së ne kemi mbështetjen e plotë të gjithë partnerëve tanë strategjikë, të cilët njëkohësisht përfaqësojnë shtetet ku është dëshmuar se privatizimi i sektorit të telekomunikimeve sjell zhvillim ekonomik. Prandaj, sot populli i Kosovës, por edhe partnerët tanë në Uashington dhe Bruksel presin përgjigje nga ne, përgjigje për ekonominë e lirë të tregut.

Pas të gjitha analizave të bëra dhe konsultimeve me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, është arritur në përfundim se tani është koha e fundit për futjen e kapitalit privat në PTK. Këtu përsëritet, po ashtu, edhe opinionin e Odës Ekonomike të Kosovës dhe të ekonomistëve tjerë kosovarë, ekspertëve tjerë kosovarë të cilët shumë fuqishëm mbështesin privatizimin e PTK-së. Të gjitha studimet e bëra për profitabilitetin e kompanive të telekomit vlerësojnë që kompanitë private të telekomit kudo në botë funksionojnë shumë më mirë se ato publike. Këtë e ilustron edhe fakti se mbi 95% të të hyrave në nivel global në sektorin e telekomit vijnë nga operatorët privatë. Ndërsa, në rajon, Kosova është e fundit me pronësi të plotë publike të operatorit të telekomit.

Ne jemi shtet i ri, por me një potencial të madh, me një moshë shumë të re mesatare, e cila ka prirje për shfrytëzimin e teknologjive më të avancuara botërore. Dhe pikërisht tani është koha që të bëhet krejt çka është e mundur që të rritet kapaciteti zhvillimor i Republikës së Kosovës.

Të hyrat që do të dalin nga ky transaksion sigurisht se do të derdhen në buxhetin e Kosovës dhe do të përdoren drejtpërdrejt për zhvillimin ekonomik të vendit, hapjen e vendeve të reja të punës dhe konsolidimit të perspektivës evropiane të vendit.

Të nderuar, të respektuar deputetë,

Dua të theksoj se strategjia e propozuar për privatizimin e PTK-së nuk është një listë dëshirash. Është, e ritheksoj, reformë ekonomike. Ai është modeli më i mirë i mundshëm që maksimalizon të hyrat për buxhetin e Kosovës dhe përfitimet më të mëdha për të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë punëtorët e tanishëm të PTK-së, si dhe punëtorët që në të ardhmen do të punojnë në PTK, klientët e tanishëm të PTK-së, si dhe klientët të cilët në të ardhmen do të përdorin shërbimet më të mira dhe më të lira të PTK-së, nxënësit që do të mund të shkojnë në shkollë të saponduar, qytetarët në vende rurale, në rrugë të re që mund të zhvillojnë aktivitete, pra në realizimin e ëndrrave të kosovarëve që përmes edhe autostradës që ka filluar së punuari e që është në rrugë shumë të mbarë, mund të udhëtojnë në Shqipëri.

Vendimi i privatizimit të PTK-së dhe dobia nga kjo nuk është vetëm për disa, nuk është vetëm për Qeverinë, nuk është vetëm për një parti. Vendimi është i të gjithë neve dhe unë jam i bindur se të gjithë ne që jemi sot këtu dhe vullneti i qytetarëve të Kosovës është që të shikojmë kah e ardhmja, kah ekonomia e lirë e tregut.

Deputetë të nderuar,

PTK do të vazhdojë të jetë kompani, një kompani kosovare, e cila do të punësojë qytetarët e Kosovës, do të vazhdojë t'i paguajë taksa shtetit të Kosovës, do të ofrojë shërbime për qytetarët e Kosovës. Po ashtu, është me rëndësi të ceket se në PTK do të futen investime të mëdha të cilat do të përbëjnë një

nga investimet më të mëdha private të deritanishme, i cili investim do të hapë rrugë për shumë investime tjera në sektorë të tjerë.

E theksoj këtu dhe garantoj se asnjë punëtor i PTK-së nuk do të humbë vendin e punës si rrjedhojë e këtij procesi. Përkundrazi, ju siguroj juve, punëtorë të PTK-së, të gjithë qytetarët e Kosovës, juve deputetë të nderuar se Qeveria e Kosovës do të garantojë vendet e punës për një periudhë minimum prej 4 vjetësh. Njëkohësisht ju informoj se ne kemi propozuar që njësia e biznesit – Posta, si një resor i rëndësishëm strategjik për shtetin e Kosovës dhe që mban obligimin universal për shërbime, t'i kthehet në pronësi shtetit të Kosovës.

Përderisa shumica e postave në tërë botën nuk janë profitabile, ne kemi dizajnuar një transaksion që siguron profitabilitetin e kësaj njësie në planin afatgjatë. Ne do të ofrojmë për shitje aksionet e Njesisë së Telekomit të PTK-së, mirëpo më shumë se 90% të aseteve të paluajtshme të PTK-së do të mbesin në pronësi të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Qeveria e Republikës së Kosovës veç se ka dëshmuar se është e hapur ndaj investimeve private, si dhe atë që të udhëheqë proceset e rëndësishme dhe shumë transparente për futjen e sektorit privat në infrastrukturën e shtetit.

Si rezultat i një procesi të tillë shumë transparent dhe të kujdesshëm të koncesionimit të Aeroportit të Prishtinës dhe angazhimit të një prej kompanive më të mëdha dhe më të fuqishme e me renome botërore për ndërtimin e autostradës, ne kemi ngritur kredibilitetin e Kosovës tek investitorët e mëdhenj kudo në botë. Si rezultat i saj, të nderuar deputetë, disa nga kompanitë më të fuqishme botërore në sektorin e telekomit veç se kanë dorëzuar aplikacionet për t'u parakualifikuar për procesin e privatizimit të Postës dhe të Telekomit të Kosovës. Këto kompani së bashku kanë rreth 370 milionë konsumatorë në tërë botën. Ky është edhe një konfirmim se PTK-ja është atraktive për investitorët e jashtëm, se Qeveria e Kosovës ka udhëhequr një proces shumë transparent dhe se privatizimi i PTK-së të jetë një proces me konkurrencë të madhe që do të sigurojë një çmim shumë të favorshëm për shitjen e aksioneve.

Të nderuar e të respektuar, deputetë,

Të gjitha përfitimet e përmendura më lartë varen nga aprovimi përfundimtar nga ana juaj të vendimit të Qeverisë për privatizimin e PTK-së. Ne i kemi dëgjuar dhe përfshirë idetë, sugjerimet, këshillat dhe rekomandimet tuaja në strategjinë përfundimtare. Ne si përfaqësues të zgjedhur të popullit nuk duhet të lejojmë që ky projekt i rëndësishëm strategjike për shtetin tonë, si dhe projektet tjera të rëndësishëm strategjike të mbeten peng i zhvillimeve politike. Secili nga ne duhet të ngrihet mbi interesat e ngushta, mbi interesat grupore, mbi interesat partiake dhe të marrë vendim për të ardhmen e shtetit dhe mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës.

Besoj dhe jam i vetëdijshëm se reforma nuk pret kohë. Sa më parë që i zhvillojmë reformat, sa më parë që i bëjmë reformat, aq më mirë është për vendin tonë dhe për qytetarët tanë, por edhe për partnerët tanë që po investojnë shumë në Republikën e Kosovës.

Besoj se është një dëm që ky proces ndodh në momentin kur Republika e Kosovës po hyn në proces zgjedhor, por ky nuk është justifikim për të mos ecur përpara. Përkundrazi, duhet të jetë motiv për vendim të drejtë, unik, shtetëror, siç e do qytetari i Kosovës dhe partnerët tanë, siç dëshirojnë t'i

dërgojmë mesazhin më të mirë të unifikimit të politikës sonë shtetërore, pa dallime partiake, për interesin e përgjithshëm.

Në asnjë rrethanë nuk duhet të lejojmë që ky proces të politizohet apo të partizohet. Përkundrazi, duhet t'iu japim mbështetje të plotë reformave ekonomike, që realisht të gjithë jemi zotuar, të gjithë i kemi proklamuar dhe të gjithë në një formë a formë tjetër kemi punuar në udhëheqjen e Republikës së Kosovës.

Sot, besoj, do të kemi një vendim pozitiv për PTK-në, për së paku 67% të aksioneve të PTK-së.

Të nderuar deputetë,

Ju informoj se në rast të ndonjë opinionit tjetër, ne, të zgjedhurit e qytetarëve të Kosovës mund të rrezikojmë largimin e investorëve të cilët kanë shprehur interes, prandaj vendimi ynë, i shumicës së deputetëve, por ju ftoj të gjithëve, pa dallime partiake, ju ftoj që të jetë në shërbim të reformës ekonomike, në shërbim të thithjes së investorëve të fuqishëm ndërkombëtarë dhe ju ftoj të gjithëve që të kuptohen shumë drejt të gjitha mesazhet më të mira të mundshme që kanë ardhur për të gjithë.

Të nderuar deputetë,

Bazuar në punën e madhe që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në faktin se kemi hyrë në një proces pak më herët se shtetet e rajonit, ne kemi arritur që të sigurojmë investorë shumë të fuqishëm, siç e ceka edhe në fillim, në shumë drejtime. Dhe këta investorë vetëm sa po rriten dhe janë prezentë në Republikën e Kosovës. Mirëpo, ata janë prezentë sepse kemi nxjerrë një legjislacion bashkëkohor, të modelit perëndimor, të standardeve evropiane dhe kemi marrë vendime të drejta, më të drejta të mundshme.

Mirëpo, shtetet tjera po ecin përpara në procesin e privatizimit dhe fatkeqësisht, pikërisht për çështjen që sot ne po e diskutojmë, fqinji ynë Serbia është duke tentuar që të pengojë këtë proces, duke lobuar që të largohen nga Kosova investorët e interesuar për privatizimin e PTK-së. Pra, kundër vendimit që do ta marrim ne sot, e kemi edhe angazhimin lobues të Serbisë kudo.

Njëkohësisht unë besoj se uniteti ynë do të jetë ai i cili do të reflektojë në përputhshmëri me interesat e shtetit të Kosovës, qytetarëve të Kosovës dhe partnerëve tanë.

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Njëkohësisht dëshiroj t'ju informoj se duke marrë një orientim tjetër, që nuk është në përputhshmëri me strategjinë, ne mund të rrezikojmë edhe realizimin e programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ky program, në bazë të të cilit është përpiluar buxheti i aprovuar në Parlament këtë verë, do të sigurojë më shumë se 80 milionë euro si ndihmë direkte buxhetore nga donatorët, si dhe vazhdimësi të ngritjes së nivelit të investimeve publike në ndërtimin e projektit të ëndrrave të qytetarëve të Kosovës, Autostradës Merdar-Morinë.

Të nderuar deputetë,

Përderisa Ligji për ndërmarrjet publike na obligon të ofrojmë për aprovim vendimin e Qeverisë për privatizim, ne përveç kësaj kemi ofruar të gjithë strategjinë e privatizimit të PTK-së, si dhe kemi marrë pjesë në Komisionin parlamentar për Ekonomi dhe jemi përgjigjur me shkrim në të gjitha çështjet e ngritura nga deputetët, në mënyrë që të sigurohemi se ekziston mirëkuptim dhe transparencë e mjaftueshme, transparencë e plotë.

Dëshiroj, të nderuar, të vlerësuar deputetë, të theksoj se procesi i shpjeguar më lartë dhe finalizimi i suksesshëm i një procesi konkurrues nuk do të jetë i mundur nëse vendoset që të ofrohen për shitje më pak se 67% të aksioneve. Investitorët seriozë të cilët veç i kanë dërguar aplikacionet për parakualifikim, nuk do të konkurrojnë për blerjen e aksioneve të PTK-së nëse nuk janë në gjendje që të marrin vendimet strategjike kur të blejnë këtë kompani. Qeveria e Kosovës, prapë do të vazhdojë të mbetet aksionari më së shumti deri 33% të aksioneve, që do të sigurojë se interesat nacionale do të mbrohen dhe se do të marrin të hyra buxhetore nga profiti i PTK-së edhe në të ardhmen.

Të nderuar deputetë,

Ne i garantojmë edhe një herë të gjithë, përfshirë edhe juve, të nderuar parlamentarë, qytetarët e Kosovës, si dhe investitorët potencialë se i gjithë procesi do të jetë transparent, i konkurrencës, i drejtë dhe se privatizimi i PTK-së do të jetë edhe një shtytje tjetër që siguron zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës dhe perspektivën evropiane.

Në fund, të nderuar deputetë, ju bëj thirrje që të mos lejojmë që projektet e rëndësisë strategjike për zhvillimin ekonomik të bëhen peng i zhvillimeve politike, pjesë e kampanjave elektorale, pra të kemi parasysh interesin afatgjatë të vendit dhe të aprovojmë Strategjinë e privatizimit të PTK-së sepse po aprovojmë një proces transparent, në dobi të qytetarëve të vendit, në dobi të shtetit tonë. Faleminderit shumë për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Sipas radhës, tani e ka fjalën zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Unë, për konsideratë ndaj kryeministrit, edhe pse e kam lypur edhe më herët fjalën, zoti kryesues, besoj se edhe tash nuk është vonë...

Absolutisht, duke e kuptuar rëndësinë e privatizimit dhe duke qenë si subjekt politik që e përkrah privatizimin, ne megjithatë konsiderojmë se nga ajo që kemi thënë herën e kaluar, asnjë ndryshim nuk ka dhe asnjë zhvillim tjetër nuk ka që e bën të ndryshojë edhe qëndrimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Dhe, qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që ky proces të jetë i analizuar mirë, të jetë transparent dhe që të shtyhet. Ky është propozimi ynë. Faleminderit!

KRYESUESI: OK. Vazhdojmë. Ne kemi hyrë Zoti kryeministër, e ka fjalën! Veç, mos u nxehni! Urdhëroni!

(Reagime)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Procesi është i analizuar shumë mirë. Unë jam këtu që të dëgjoj të gjitha rekomandimet shtesë, të cilat mund të vijnë nga të gjitha grupet parlamentare, ndërsa shtyrje nuk do të ketë, do të ketë votim.

KRYESUESI: Sipas Rregullores, kryetarja e Komisionit për Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion nuk e dëshiron fjalën. Tani, sipas radhës, fjalët i kanë kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, kush e ka fjalën? Kryetari i Grupit, Ramë Buja. Ju lus për qetësi, të nderuar deputetë!

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (ndërprerje incizimi, pengesë në incizim)...mbështet propozimin e Strategjisë dhe vendimit të Qeverisë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës dhe propozoj që të shkohet në votim dhe të mos ketë shtyrje më.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e dha propozimin. Keni propozim shtesë, në emër të grupit? Nuk ka. Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kush e kërkon fjalën? Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Rrjedha se si ka ardhur deri te ky moment tregon joseriozitetin e Qeverisë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës, prandaj ne e përkrahim propozimin e zotit Beqiri që Strategjia për privatizimin e Postës të ketë një analizë më të thellë, të ketë një strategji të vërtetë dhe të mos ketë vetëm letra, por të jetë strategji e vërtetë që ekonominë e Kosovës e zhvillon dhe qytetarët e Kosovës të kenë një mirëqenie më të madhe.

Prandaj, ne si grup nuk e përkrahim këtë strategji, sepse është në dëm të qytetarëve të Kosovës dhe është në dëm të interesit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Ky proces, po shihet që ka filluar mbrapsht, prandaj edhe përfundimin do ta ketë mbrapshtë, për fat të keq dhe unë konsideroj se nuk do të duhej përdorur tash për efekte të fushatës paraelektorale.

AKR-ja nuk është kundër privatizimit, sepse shpeshherë është paraqitur jo drejt qëndrimi i AKR-së që është kundër privatizimit. Ne nuk jemi kundër privatizimit, por jemi deklaruar se jemi kundër formës së privatizimit, kundër modaliteteve dhe kundër kohës së privatizimit të PTK-së.

Nganjëherë është vështirë të kuptohet se çka dhe pse ndodhin gjërat kaq shpejt. Përderisa, në njërën anë e kemi deklaratën e Qeverisë së Kosovës për menaxhim të mirë të PTK-së, në anën tjetër kemi sugjerime të bashkësisë ndërkombëtare ose të miqve tanë, siç jemi mësuar ose siç u themi ne, që PTK-ja duhet të privatizohet për shkak të keq menaxhimit. Kështu ka qenë edhe një deklaratë e djeshme e disa miqve ndërkombëtarë.

Sikur e thashë, qëndrimi i AKR-së tashmë është i qartë. Ne jemi kundër kohës së privatizimit sepse edhe ashtu institucionet janë në fund të mandatit dhe nuk do të duhej të ndërmerren veprime strategjike në fund të mandatit. Megjithatë, deputetët e grupit parlamentar janë të lirë që me vullnetin e vet të vendosin përkritazi me çështjen nëse do të votojnë për ose kundër. Përndryshe, qëndrimi i AKR-së është shumë i qartë. Jemi kundër privatizimit në këtë formë çfarë po i ofrohet këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë vazhdimisht e ka potencuar se logjika e veprimit të kësaj qeverisjeje është kontraproduktive dhe është në dëm të interesave ekonomike të vendit.

Ne jemi kundër, ashtu siç kemi qenë, kundër kësaj strategjie të privatizimit, për tri arsye kryesore, të cilat i kemi potencuar në vazhdimësi, dhe ato janë:

Asnjëherë nuk është dhënë arsyeshmëria ekonomike për asetin më profitabil të vendit pse duhet të privatizohet tani. Ka munguar në vazhdimësi transparencja dhe ajo çka është më e rëndësishmja dhe çka ka kërkuar vazhdimisht Kuvendi i Kosovës – nuk kemi legjislacion adekuat për privatizimin e ndërmarrjeve publike, në kuptimin e asaj që të mos shkojë privatizimi i aseteve kryesore të vendit, siç ka shkuar i tërë procesi i privatizimit gjer tani.

Prandaj, kërkojmë nga deputetët që të mos përkrahet një strategji e tillë e privatizimit të PTK-së për arsye se është në dëm të drejtpërdrejtë dhe i dëmton interesat e vendit dhe të shoqërisë kosovare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, kush e do fjalën? Deputeti Xhezair Murati!

DŽEZAIR MURATI: Faleminderit, kryesues!

Mi u Parlamentarnoj grupi “7+” podržavamo proces privatizacije, ali ono što smo naveli i u nekim prethodnim kontaktima, želimo da naglasimo da se vodi računa sa budućim vlasnicima oko kvaliteta usluga, oko strategije zapošljavanja i zaštite radnika.

Parlamentarna grupa “7+” će podržati proces privatizacije. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, kush e ka fjalën? Deputeti Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Dame i gospodo, prisutni,

Parlamentarna Grupa SLS smatra da (pengesë në incizim) ... treba odlagati ovo pitanje i mi bi želeli da ovo pitanje uđe u proces glasanja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, kush e ka fjalën? Deputeti Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsjedavajući!

Uvaženi premijeru,

Zameniće,

Gospodo ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Uvažavajući zaista jedan ozbiljan proces kosovskog društva, a to je privatizacija jednog giganta, kao što je PTK-a, sigurno možda je nezgodno vreme, s obzirom da je zaista jedan kraj nekog parlamentarnog procesa, ali sigurno je jako bitno da se ovaj proces nastavi u jednom pozitivnom smislu. I prema tome, sigurno da interes i ove poslaničke grupe je da taj proces ima svoj kraj u smislu

da li prihvata ti ili ne prihvata ti, i mi ćemo kao Poslanička grupa glasati, ali onako kako svaki od poslanika iz Poslaničke grupe smatra da treba da glasa. Hvala najlepše!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani grupet parlamentare janë deklaruar. Sipas radhës, janë paraqitur disa deputetë për të diskutuar. Ju lus, ju lus deputetë, Rregullorja e Kuvendit për të gjithë është njësoj. Mos u nervozoni! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi. Aha, unë ua dhashë fjalën më parë. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, unë nuk di... unë nuk shoh asnjë nevojë për farë tensioni dhe gjuajtje të fjalës aty-këtu. Unë po ju lus! Propozimi ynë është që të shtyhet dhe këtë unë kam të drejtë të kërkoj të qitet në votim, zoti kryesues, një propozim i një grupi parlamentar. Kjo është e rregulluar me Rregullore dhe unë kam të drejtë në emër të grupit, dhe unë nuk jam person privat këtu dhe nuk flas në emrin tim.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka thënë mendimin e vet dhe zoti kryeministër, unë, me gjithë respektin, po e them qëndrimin e grupit dhe Xhavit Haliti e udhëheq këtë seancë. Nëse s'e udhëheq Xhavit...

(Reagim)

...sepse, po reagoni. Unë, zoti kryesues, ju lus që propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, edhe një herë po e përsëris, jo kundër privatizimit, mos të manipulohet, por për një proces të mirëfilltë çfarë e meriton ky vend. Në mes rekomandimeve, nuk dua të lëshohem në debat, dhe asaj çka thuhet në strategji, ka dallim të madh. Andaj, propozimi ynë është të shtyhet për t'u analizuar dhe për t'u sqaruar gjërat. Kjo është kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së.

(Ndërprerje e incizimit)

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Kemi të lajmëruar 13 – 14 deputetë për debat.

(Ndërhyrje)

Atëherë, sipas Rregullës 50, mocionet procedurale, pika 3, unë po ua lexoj dhe ju dëgjoni: “Për mocionin për ta shtyrë debatin për një mbledhje tjetër dhe për mocionin për ta shtyrë mbledhjen, votohet menjëherë dhe pa debat”.

(Ndërhyrje, shprehje mospajtimi)

Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit!

(Ndërhyrje, shprehje mospajtimi)

KRYETARI I KUVENDIT: Gani, Gani, thamë pa debat! Urdhëro, shko në vend! Ju lutem, s'ka nevojë për procedurë, se procedurë është Rregullorja dhe për procedurën tash, unë e udhëheq këtë. Ju

lutem! Ju lutem! Ne po votojmë për mocionin “për”, apo “kundër”. Për ta shtyrë, ose për të mos e shtyrë këtë pikë të rendit të ditës. Prandaj, ju lutem, përgatituni për votim. Urdhëro, kryeministër, merre fjalën!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Të nderuar deputetë, kryeministri flet në çdo kohë me Rregullore, prandaj ju lutem për qetësi! E dëgjojmë dhe përsëri votojmë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,
Unë përfaqësoj interesat e shtetit të Kosovës dhe jo vetëm të një grupimi partiak...

(Ndërhyrje, shprehje mospajtimi)

... Unë mendoj se ose duhet të futemi në votim të Strategjisë, kush është për privatizim dhe kush është kundër. Rendi i ditës është shumë i qartë. Sikur të kërkohej mocioni fillimisht para se të fillonte debati, është në përputhshmëri me Rregulloren, le të zhvillohet debati, pastaj marrim një qëndrim të përbashkët. Le të hapet debati, ta dëgjojmë secilin, t’i marrim rekomandimet. Ju, disa nga ju, edhe po i jeni kundër privatizimit, edhe kundër debatit, prandaj le të hapet debat.

KRYETARI: Unë konsideroj që debati është harxhuar dhe nuk duhet të debatojmë për këtë çështje. Konsideroj që deputetët duhet të jenë në përgjegjësinë e detyrave që kanë. Është kërkesë e mocionit dhe votojmë për mocionin. Mocioni është për ta shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për një seancë tjetër. Urdhëro, sqarim, por nuk ka nevojë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë e kuptoj, zoti Krasniqi, që përpiqeni të krijoni një konsensus në kuptimin e aprovimit të kësaj strategjie, që është shumë në rregull dhe pajtohem. Por, duhet të kemi parasysh edhe diçka. Duhet të kemi parasysh se interpretimin tuaj të Rregullores e pranoj, megjithëse dialogu kishte... megjithëse e pranoj dhe e vlerësoj, sepse jeni kryetar i Parlamentit, por në të njëjtën kohë dëshiroj të theksoj se tendenca për shtyrje të privatizimit është qëndrim kundër privatizimit...

(Reagime)

... në të njëjtën kohë pranoj me mirëkuptimin më të lartë që të futet si mocion, por përsëri në seancën e ardhshme të jetë pika e parë e rendit të ditës.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Vazhdojmë dhe votojmë për mocionin për shtyrjen e debatit për seancë të radhës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 53 vota “kundër”, 1 abstenim, 46 “për”, në fakt votohet kundër mocionit.

Ju lutem, tash votojmë “për”, kush është “për” strategjinë e ofruar nga Qeveria?

(Ndërhyrje)

Regjia, votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 1 abstenim, 2 “kundër”, miratohet strategjia.

(Duartrokitje)

Seanca përfundoi! Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve